

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE

FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT

Programi: Studime për gjuhën shqipe – Gjuhësi



PUNIM MASTERI

PËRFSHIRJA E AUTORËVE TË LETËRSISË SË SOTME SHQIPE NË TEKSTET SHKOLLORE VI-IX

Mentori:

Prof. Dr. Zeqir Kadriu

Kandidatja

Florina Ejupi

Tetovë, 2019

Deklaratë e autorësisë

Unë deklaroj se të gjitha informacionet që kanë të bëjnë në këtë dokument janë marrë dhe paraqitur në bazë të rregullave akademike dhe në bazë të sjelljeve etike.

Gjithashtu deklaroj se të gjitha shënimet dhe rezultatet në këtë punim që nuk janë punë origjinale e imja i kam cituar të gjitha materialet në bazë të rregullave akademike.

Florina Ejupi

Mars, 2019

Falënderim

Një falënderim të veçantë dëshiroj ta shpreh për mentorin tim Prof. Dr. Zeqir Kadriun për ndihmën dhe mbështetjen e çmuar që më ofroi gjatë gjithë punës sime dhe për kontributin në finalizimin e këtij punimi.

Falënderoj të gjithë profesorët e Universitetit të Evropës Juglindore, të cilët kontribuan në arritjen time. Gjithashtu, u jam mirënjohëse kolegëve dhe personave të tjerë të cilët në një mënyrë apo tjetër kontribuan në arritjen time deri këtu.

Dëshiroj, në fund të shpreh një mirënjohje të thellë për prindërit e mi të cilëve i detyrohem shumë për fillimin dhe finalizimin me sukses të këtij udhëtimi, sa të vështirë aq edhe të bukur. Këtë punim ia dedikoj familjes sime, që pa mbështetjen dhe durimin e të cilëve nuk do të ishte e mundur të finalizohet kjo punë.

Abstrakt

Ky punim masteri trajton përfshirjen e autorëve të letërsisë së sotme shqipe në tekstet shkollore të klasave VI-IX, përkatësisht në tekstin “Leximi letrar”.

Në pjesën teorike të punimit do të shpërfaqim ndarjen e letërsisë shqiptare në periudha, por më shumë do të fokusohemi tek letërsia bashkëkohore. Ndërsa, korpusi hulumtimit është i ngritur mbi bazën e librave shkollore të klasave VI-IX, përkatësisht “Leximi letrar”, kështu do të shpërfaqim përfshirjen e autorëve të letërsisë së sotme shqipe, pjesë të shkëputura nga veprat e tyre si dhe rëndësia e autorëve dhe e shkrimeve të tyre për nxënësit e shkollave fillore. Në bazë të këtij korpusi do të realizohen edhe pyetësorë me mësimdhënës dhe nxënës të SHFMU “Isa Boletini” dhe SHFMU “Bekim Sylka” në Rahovec. Përmes pyetësorëve do të shohim se sa janë përfshirë autorët e letërsisë bashkëkohore në tekstet shkollore, cilat tema preken më shumë, sa i përshtaten moshës së fëmijëve këto tema, cilat janë metodat e punës së mësimdhënësve, sa janë produktive dhe a sjellin risi ato te nxënësit në të nxënit e tyre për letërsinë, dhe sa motivohen nxënësit të kycen në mësim, etj. Si përfundim shfaqen rezultatet e pritura të nxënësve sa kanë marrë njohuri, sa arrijnë të thellohen, të zgjerojnë e praktikojnë njohuritë për letërsinë.

Për realizimin e punimit është zbatuar metoda krahasuese dhe përshkruese, metoda këto që përfshijnë informacionet më të sakta për qëllimin tonë. Po ashtu do të përdorë edhe metodën e statistikave për të nxjerrë përqindje të ndryshme.

Fjalët kyçe: *letërsi, letërsi bashkëkohore, lexim letrar, autorë shqiptarë.*

Abstract

This master paper treat the inclusion of authors of today's Albanian literature in textbooks of grades VI-IX, respectively in the text "Literary reading".

In the theoretical part of the paper we will present the division of Albanian literature in periods, but more will focus on contemporary literature. Meanwhile, the research corps is based on the class books VI-IX, respectively "literary reading", so we will present the inclusion of authors of today's Albanian literature, portions of their works and the importance of authors and of their writings for elementary school students. Based on this corpus, questionnaires will be realized with teachers and pupils of SHFMU "Isa Boletini" and SHFMU "Bekim Sylka" in Rahovec. Through questionnaires, we will see how many authors of contemporary literature in the textbooks are involved, which topics are more affected by the age of children, these topics, what are the methods of teacher work, how productive they are and bring innovation to the students in their learning about literature, and how motivated they are to engage in learning, etc. In conclusion the expected student outcomes, how much they have acquired knowledge, how to deepen, expand and practice literary knowledge.

For the implementation of the work, comparative and descriptive methods have been applied, methods that include the most accurate information for our purpose. It will also use the statistical method to generate different percentages.

Key words: *literature, contemporary literature, literary reading, Albanian authors.*

Tabela e përmbajtjes

Deklaratë e autorësisë	2
Falënderim	3
Abstrakt	4
Abstract	5
Hyrje.....	9
Qëllimet e hulumtimit.....	10
Rëndësia e punimit	10
Hipotezat e hulumtimit	11
Metodologjia e punimit.....	11
Fazat e kërkimit.....	11
KAPITULLI I	13
1. Historia e letërsisë.....	13
1.1 Letërsia shqiptare.....	14
1.1.1 Letërsia e vjetër shqipe	16
1.1.3 Letërsia e Rilindjes.....	19
1.1.5 Letërsia bashkëkohore	21
KAPITULLI II.....	23
2. Letërsia e sotme shqipe	23
2.1 Autorët e letërsisë së sotme shqipe.....	25
KAPITULLI III.....	38
3. Historia e letërsisë shqiptare dhe disa probleme me tekstet shkollore.....	38
KAPITULLI IV	41
3. Shpalosja e programit të leximit letrar VI-IX.....	41
3.1 Autorët më të spikatur të letërsisë së sotme shqipe në tekstet shkollore	62
3.1.1 Analiza e teksteve.....	63
3.2 Statistikë.....	66
KAPITULLI V.....	69
5. Vëzhgim dhe analizë e pyetësorëve	69
5.1 Vëzhgimi dhe metodat e punës	69
5.2 Analizë e pyetësorëve	72
5.2.1 Pyetësor për mësimdhënës.....	72

5.2.2 Pyetësor për nxënës	82
Përfundim	92
Bibliografia	93
Shtojca	95
Pyetësor për mësimdhënës	95
Pyetësor për nxënës	97

Lista e tabelave dhe grafikoneve

Tabela 1. Periodizmi sipas Qosjes	15
Tabela 2. Autorët më të spikatur të letërsisë bashkëkohore në tekstet shkollore	62
Grafikoni 1. Përfshirja e autorëve të letërsisë së sotme shqipe në tekstet shkollore	68
Grafikoni 2. Cilat tema preken më shumë në leximin letrar të klasave VI-IX?	72
Grafikoni 3. A i përshtaten moshës së fëmijëve këto tema?	73
Grafikoni 4. Cilat janë metodat që i përdorni më shpesh gjatë punës?	74
Grafikoni 5. A motivohen nxënësit të kyçen në mësim përmes këtyre metodave?	75
Grafikoni 6. Sa janë produktive dhe a sjellin risi ato te nxënësit në të nxënit e tyre për letërsinë?	76
Grafikoni 7. Cila letërsi është e përfshirë më shumë në leximin letrar të klasave VI-IX?	77
Grafikoni 8. A duhet të përfshihen më shumë autorët e letërsisë së sotme shqipe në tekstet shkollore?	78
Grafikoni 9. A duhet të bëhet një rishikim i leximeve letrare, që nxënësit të marrin njohuri më shumë për letërsinë?	79
Grafikoni 10. A kanë pasur njohuri paraprake nxënësit për veprat e shkrimtarëve të letërsisë së sotme shqipe?	80
Grafikoni 11. Cilët autorë janë përfshirë më shumë në leximin letrar VI-IX?	81
Grafikoni 12. Në cilat vite filloi zhvillimi i letërsisë bashkëkohore?	82
Grafikoni 13. Në sa periudha ndahet letërsia shqipe?	83
Grafikoni 14. Cili autor i përket letërsisë së vjetër shqipe?	84
Grafikoni 15. Cili autorë i përket letërsisë moderne shqipe?	85
Grafikoni 16. Cili autorë i përket letërsisë bashkëkohore shqipe?	86

Grafikoni 17. A janë këto shkrimtarë bashkëkohorë: Dritëro Agolli, Jakov Xoxa, Rexhep Qosja dhe Ag Apolloni?	87
Grafikoni 18. Nga cili autor është shkruar vepra “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”?.....	88
Grafikoni 19. Kush e ka shkruar poezinë “Me jetue”?	89
Grafikoni 20. A keni lexuar ndonjë vepër të autorit Ag Apolloni?	90
Grafikoni 21. Cila ishte tema kryesore e veprës “Kështjella” e shkrimtarit Ismail Kadare? ..	91

Hyrje

Letërsia është një bashkësi objektesh e rregullash, teknikash e veprash, funksioni i të cilave në strukturën e përgjithshme të shoqërisë është të funksionalizohet subjektiviteti.

Sa i përket çështjes së periudhave letrare, Ibrahim Rugova në korpusin e studimeve të veta të botuara më 2002 propozon: *Letërsia filobiblike*, *Letërsia romantike*, *Letërsia moderne*, *Letërsia bashkëkohore*.

Siç e kemi mësuar edhe më herët, e dimë paraprakisht se letërsia është shkencë në vete, ajo thuhet ndryshe “art i fjalës”. Kjo veprimtari krijuese, botën gjerë e gjatë, me përbërësit e saj, qoftë në mënyrë konkrete apo fiktive, e pikturon përmes fjalës së shkruar dhe i këndon përmes tingujve dhe kuptimit të tyre.

Letërsia e sotme shqipe apo bashkëkohore filloi në vitet '50. Ajo karakterizohet me të veçantat e saj, njëjtë sikurse letërsitë pararendëse.

Qasja e re dhe moderniste e realitetit të kohës, ideja aktuale dhe e thellë njerëzore, trajtimi i së kaluarës, vizioni ndaj së ardhmes, etj., janë shquarsitë e Letërsisë së sotme shqipe.

Kjo periudhë letrare kishte një numër të konsiderueshëm shkrimtarësh në “Leximin letrar” të klasave VI-IX. Vetëm se në “Leximin letrar VI” përfshihen autorët si: Sterjo Spasse, Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Azem Shkreli, Ali Podrimja, Sabri Hamiti, Agim Vinca, Ramiz Kelmendi, etj. Pastaj në tekstet tjera në vazhdim, i kemi po këta shkrimtarë por edhe disa të tjerë të kësaj periudhe, prej të cilave janë marrë tregime e poezi të shkëputura prej veprave të tyre.

Gjatë studimit tim në tekstet shkollore të klasave VI-IX, përkatësisht në tekstin “Leximi letrar” përfshihen kryesisht autorët e Letërsisë së sotme shqipe në këto tekste, pjesë të shkëputura nga veprat e tyre, rëndësia e autorëve dhe e shkrimeve të tyre për nxënësit e shkollave fillore.

Do të fillojmë me metodat e punës, si mësohet, cilat janë temat që preken më shumë, sa i përshtaten ato moshës së fëmijëve në klasat e caktuara.

Motivi kryesor i këtij punimi është të trajtohen pjesa teorike dhe praktike, në përcjellje të nxënësve nga niveli më i ulët në nivelin më të lart të klasave, cilat janë metodat e punës së

mësimdhënësve, sa janë produktive dhe a sjellin risi ato te nxënësit në të nxënit e tyre për letërsinë, dhe sa motivohen nxënësit të kyçen në mësim.

Synimi i këtij punimi është të arrijnë të bëjnë ndarjen e letërsisë nëpër epoka, duke dalluar krijimet e tyre, tregimet, prozën, poezinë.

Gjithmonë mbështetemi në didaktikën e mësimit të letërsisë, përfaqësimin e autorëve në tekstet shkollore, në mësimdhënien e arsimtarëve e mësimnxënien e nxënësve në këtë fushë, si dhe ndikimi i mësimdhënësit në përvetësimin dhe mësimin e diçkaje të re.

Si përfundim shfaqen rezultatet e pritura të nxënësve sa kanë marrë njohuri, sa arrijnë të thellohen, të zgjerojnë e praktikojnë njohuritë për letërsinë.

Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi i punimit tim është të shpaloset përfaqësimi i autorëve të letërsisë së sotme shqipe në tekstet shkollore VI-IX, dhe të shohim se sa janë të përfshirë këto autorë dhe me cilat vepra janë përfaqësuar. Gjithashtu qëllimi tjetër është edhe që të shohim se sa kanë njohuri nxënësit për letërsinë e sotme shqip.

Ky punim del të jetë me shumë rëndësi, ngase shpalos se sa u ofrohet nxënësve njohuri nga letërsia në tekstet shkollore, kryesisht nga letërsia e sotme shqipe si pjesë bazë e këtij punimi.

Rëndësia e punimit

Tema në fjalë, na ofron mundësinë të njihemi ne për së afërmi me autorët e Letërsisë së sotme dhe përfshirjen e tyre në tekstet shkollore.

Rëndësia e këtij punimi është trajtimi i autorëve të Letërsisë së sotme shqipe në tekstet shkollore VI-IX .

Kjo temë, si qëllim të hulumtimit fokusin kryesor e ka të nxjerrë fakte në tekstet bazë të para nga këndvështrimi ynë dhe problematikat që i hasim në këto tekstet shkollore.

Hipotezat e hulumtimit

Autorët e Letërsisë së sotme shqipe janë më përfaqësuesit në të gjitha tekstet shkollore të Leximit letrar nga klasa VI deri në klasën e IX , sepse shkrimet e tyre trajtojnë tema aktuale dhe përdorin gjuhë standarde.

Metodologjia e punimit

Për hartimin e hulumtimit tim me temë “Përfshirja e autorëve të letërsisë së sotme shqipe në tekstet VI-IX”, jam bazuar fillimisht në literaturën bazë të këtyre klasave.

Pas kësaj bëhet shqyrtimi i literaturës përkatëse duke u bazuar në informacione të sakta për të arritur konkluzione të caktuara rreth kësaj teme.

Metoda e përdorur gjatë hulumtimit është metoda krahasuese dhe përshkruese, metoda këto që përfshijnë informacionet më të sakta për qëllimin tonë. Po ashtu do të përdor edhe metodën e statistikave për të nxjerrë përqindje të ndryshme rreth përfshirjes apo mospërfshirjes së autorëve të kësaj periudhe në tekstet shkollore.

Responentët kryesorë të hulumtimit janë dy shkolla fillore në qytetin e Rahovecit, në të cilat do të bëhet hulumtimi. Është SHFMU “Isa Boletini” dhe SHFMU “Bekim Sylka”.

Për qëllime të caktuara të aplikimit të studimit do të bëhen edhe disa pyetësorë me nxënës dhe mësime, që lidhen me çështje të mësimi të letërsisë e më gjerë.

Fazat e kërkimit

Faza përgatitore

- Studimi i teksteve të Leximit letrar VI-IX
- Formulimi i platformës studimore “Përfshirja e autorëve të Letërsisë së sotme shqipe në tekstet shkollore VI-IX”

Faza e mbledhjes së të dhënave

- Studimi i çdo teksti në veçanti

- Studimi i literaturës, analiza e informacioneve dhe të dhënave rreth temës përkatëse

Shqyrtimi i të dhënave dhe analiza e tyre

- Përqasja me studime të mëparshme
- Analiza të thelluara mbi tekstet shkollore në përgjithësi, motivet dhe temat e trajtuara
- Përgjithësime dhe përfundime

Metodologjia e kërkimit

- Në bazë të qëllimit të punimit, metodologjia e kërkimit mbështetet në kërkimet e teksteve shkollore Leximi letrarë (VI-IX)
- Tekstet analizohen secila në veçanti dhe arrihet përfundimi

KAPITULLI I

1. Historia e letërsisë

“Njeriu është i prirun për punë e krijimtari prej natyre”¹

Në fillim është e domosdoshme të bëjmë një dallim midis letërsisë dhe studimit të letërsisë. Ato janë veprimtari të ndryshme: njëra është krijuese, është art; tjetra edhe pse nuk është shkencë në kuptimin e saktë të fjalës, prapëseprapë është një nga llojet e njohjes ose të veprimtarisë shkencore.²

Letërsia është një bashkësi objektesh e rregullash, teknikash e veprash, funksioni i të cilave në strukturën e përgjithshme të shoqërisë është të funksionalizohet subjektiviteti.³

Letërsia është institut shoqëror, që përdor si mjet komunikimi gjuhën, e cila, gjithashtu, është institut shoqëror. Shoqërore për nga vetë natyre e tyre janë edhe mjete të tilla letrare, si simbolika e metri. Ato janë konvencione e norma që mund të lindin vetëm në shoqëri. Përveç kësaj, letërsia “pasqyron” “jetën”, kurse “jeta”, në kuptimin e gjerë të fjalës, është realiteti shoqëror edhe pse objekte të “imitimit” letrar kanë qenë edhe bota e natyrës, edhe bota e brendshme apo subjektive e individit.⁴

Termi “histori e letërsisë” haset herët, diku rreth mesit të shekullit XVI.⁵ Historia e letërsisë është degë tjetër e rëndësishme e shkencës që e studion letërsinë. Kjo e përcjell zhvillimin e letërsisë (edhe të letërsisë gojore edhe të letërsisë së shkruar) që nga kohët më të lashta e deri në ditët tona. Detyrë kryesore e historisë së letërsisë është të hetojë ligjshmërinë kryesore të zhvillimit historik të letërsisë; ajo ka për detyrë të vërë në pah pleksjen e saj me realitetin, vartësinë e saj nga kushtet dhe ngjarjet historike, shoqërore, ekonomike, kulturore, etj.⁶

¹ Gani Luboteni, “Teoria e letërsisë”, Beograd, 1964.

² Rene, W., Austin, W., “Teoria e letërsisë”, Tiranë, 2007, f. 11.

³ Roland Barthes, “Oeuvres completes II”. 2002. Art. Historie au Litterature. f. 178.

⁴ Rene, W., Austin, W., “Teoria e letërsisë”, Tiranë, 2007, f. 94.

⁵ Zejnullah Rrahmani “Teoria e letërsisë”, Prishtinë, 1999, f. 13.

⁶ Ali Aliu “Teoria e letërsisë”, Prishtinë, 1986, fq. 7.

Historia e letërsisë mund të shkruhet duke pasur parasysh periudhat, lëvizjet apo shekujt kalendarikë.⁷

1.1 Letërsia shqiptare

Shkrimet e natyrës historike në kulturën letrare shqiptare kanë nisur me doracakët, antologjitë e komentuara, kanë vijuar me tekste historiografike të tipit tradicionalist. Më tej, është pretenduar të shkruhet historia e një formacioni/romantizmi.⁸

Vepra *Shkrimtarët shqiptarë*, e vitit 1941-1942 (mledhë e punue nën kujdesin e Enes Koliqit, nga Namik Resuli) është një vepër kolektive në dy vëllime, që ka pretendimin e një sistematizimi të letërsisë shqipe nga fillimet e saj deri në kohët aktuale. Pjesa e parë ka shtatë kaptina përkufizuese e karakterizuese: I. *Dokumentet e para të gjuhës shqipe*, II. *Shkrimtarët e vjetër të Veriut*, III. *Shkrimtarët e vjetër të Jugut*, IV. *Shkrimtarët e vjetër myslimanë*, V. *Prodhimi letrar përpara Lidhjes së Prizrenit*, VI. *Prodhimi letrar i Arbreshve t'Italis*, VII. *Arbëreshët e Greqis*. Pjesa e dytë e librit ka tri kaptina: I. *Shkrimtarë të Rilindjes*, II. *Shkrimtarë të kohës*, III. *Shkrimtarë Arbëreshë*.⁹

Historiani i njohur i letërsisë Rexhep Qosja, në studimin *Periodizimi i letërsisë shqipe*, të vitit 199, duke shqyrtuar kriteret e një historie të letërsisë shqipe propozonte këtë periodizim:

1. Romantizmi (që nis më 1836),
2. Romantizmi-Realizmi-Simbolizmi (që nis më 1902),
3. Letërsia sociale (që nis më 1934),
4. Realizmi integral (pa një datë të fiksuar të nisjes)

⁷ Rene, W., Austin, W., *“Teoria e letërsisë”*, Tiranë, 2007, f. 386.

⁸ Qosja, Rexhep, *“Historia e letërsisë shqipe – Romantizmi I, II, III”*, Prishtinë, 1984-85, f. 45

⁹ *“Historia e letërsisë shqipe”*, materialet e Konferencës shkencore 30-31 tetor 2009, në Prishtinë. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2010. f.f. 13-14.

Qosja këtë periodizim e jep në trajtë të tabelës me dy hyrje *Jeta* dhe *Forma*:¹⁰

Tabela 1. Periodizmi sipas Qosjes

Jeta	I. ROMANTIZMI	1836
Forma	Historia – Shkrimtari – Kombi Epika – Shkrimtari – Lirika	—
Jeta	II. ROMANTIZMI – REALIZMI – SIMBOLIZMI	1902
Forma	Kombi – Shkrimtari – Shoqëria – Arti Lirika – Shkrimtari – Proza (novela, tregimi, skica)	—
Jeta	III. LETËRSIA SOCIALE	1934
Forma	Gjendja sociale – Shkrimtari – Ideologjia Proza (tregimi, novela, romani) – Shkrimtari – Lirika - Drama	—
Jeta	IV. REALIZMI INTEGRAL	1960
Forma	Njeriu – Bota – Shkrimtari – Arti Proza (romani – novela – tregimi) – Shkrimtari – Kritika – Lirika – Drama	—

Rexhep Qosja në veprën e tij *Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi I,II,III* të vitit 1984, që në parathënie skicon një periodizim tjetër të plotësuar të letërsisë shqipe, duke e paralajmëruar me titujt punues të veprave të veta: *Letërsia e vjetër, Romantizmi, Prej romantizmit deri te realizmi, Letërsia sociale dhe Letërsia e sotme*.¹¹

Sa i përket çështjes së periudhave letrare, Ibrahim Rugova në korpusin e studimeve të veta të botuara më 2002 propozon:

1. Letërsia filobiblike,
2. Letërsia romantike,
3. Letërsia moderne,
4. *Letërsia bashkëkohore*.¹²

¹⁰ Qosja ,Rexhep, “*Prej Tipologjisë deri te periodizimi*”, Prishtinë, 1979, f. 356

¹¹ “*Historia e letërsisë shqipe*”, materialet e Konferencës shkencore 30-31 tetor 2009, në Prishtinë. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2010. f. 15.

¹² “*Historia e letërsisë shqipe*”, materialet e Konferencës shkencore 30-31 tetor 2009, në Prishtinë. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2010. f. 17.

1.1.1 Letërsia e vjetër shqipe

Letërsia e vjetër shqiptare që rrok tre shekujt e parë të shkrimit të saj nga Barleti deri te De Rada, duhet parë në vështrimin historik dhe tipologjik të saj.

Letërsia e vjetër shqiptare ka kaluar nëpër tri faza letrare, të cilat Çabej i quante edhe *periudha*:

- E para: *Letërsia e humanizmit* në shekullin XVI, me përfaqësues kryesor Marin Barletin.
- E dyta: *Letërsia filobiblike*, që përfshinë autorët e shekujve XVI, XVII e XVIII: Gjon Buzukun, Pjetër Budin, Frang Bardhin, Pjetër Bogdanin, Lekë Matrangën, Jul Varibobën e Pjetër Zarishin.
- E treta: *Letërsia jofetare, laike* e Vjershëtarëve (Bejtexhinjve) të shekullit XVIII, me përfaqësues Nezim Beratin, Hasan Zyko Kamberin, Muhamed Kyçkun etj.¹³

1.1.1.1 Humanizmi dhe letërsia filobiblike

Shkrimi shqip si dhe temat shqiptare u shfaqën të përbotshme vetëm me zhvillimin e dy lëvizjeve të mëdha kulturore e fetare evropiane-perëndimore të shekullit XVI; gjatë Humanizmit dhe Rilindjes si dhe gjatë Reformës e Kundërreformës. Humanizmi lindi e u zhvillua së pari në Itali, ku u shkolluan edhe mjaft dijetarë shqiptarë të kohës (Barleti, Beçikemi, Leonid Tomeu etj). Reforma si frymë fetare e mësimi të Luterit në Gjermani, me kërkesën për pavarësi prej kishës së Romës, nuk pati ndikim në tokat shqiptare. Këtu ishte krijuar një gjendje krejt tjetër: në një anë krishtërimi që mbizotërohej nga ortodoksizmi, nga ana tjetër islamizmi që vinte bashkë me perandorinë osmane dhe që rrezikonte krishtërimin. Prandaj, kuptohet pse këtu ngjarjet fetare lanë gjurmët dhe ndikimin e vet në letërsi, si dhe shpjegohet arsyeja përse autorët e parë të shkrimit shqip janë të gjithë priftërinj. Kështu libri i parë në shqip, Meshari i Gjon Buzukut (1555), do të jetë i kohës së humanizmit dhe i kundërreformës. Mandej vijnë autorët e tjerë: Budi, Bardhi, Bogdani, e të tjerë me radhë.¹⁴

Marin Barleti (rreth 1460-1513) - është humanisti më i madh shqiptar, ndërsa me veprën e tij “Histori e Skënderbeut” ai e lidh përgjithmonë emrin e tij me emrin e Skënderbeut. Ata

¹³ Sabri Hamiti, “*Letërsia e vjetër shqiptare*”, Prishtinë, 2007, f.f. 74-75.

¹⁴ Sabri Hamiti, “*Letërsia e vjetër shqiptare*”, Prishtinë, 2007, f. 88.

ishin burra të një epoke; lidhja e tyre krijoi një model kulturor shqiptar; heroizmin jetësor dhe himnizimin letrar, që do të mbetet për pesë shekuj model mbizotruës i kulturës së shkruar shqipe.¹⁵

Gjon Buzuku (rreth 1460-1513) - është autori i librit të parë në gjuhën shqipe dhe vepra e tij Meshari (1555) është dëshmia e parë me vlerë kulturore e gjuhësore.¹⁶

Pjetër Budi (1566-1622) – pas Gjon Buzukut, Pjetër Budi është figura më e madhe e letërsisë së vjetër shqiptare; ai vlerësohet si poeti i parë shqiptar, dhe shkrimtari i parë martir që luftoi deri në fund të jetës për idetë e tij atdhetare.¹⁷

Frang Bardhi (1606-1643) – në historinë e letërsisë së vjetër njihet si hartuesi i Fjalorit të parë shqiptar, që është njëkohësisht dhe vepra e parë shqipe pa përmbajtje fetare.¹⁸

Pjetër Bogdani (1630-1689) – është shkrimtari i fundit dhe më origjinali në Letërsinë e hershme të shqiptarëve, ndërsa vepra e tij “Çeta e profetëve” është vepra e parë e rëndësishme në prozë e shkruar drejtpërsëdrejti në gjuhën shqipe.¹⁹

1.1.1.2 Letërsia e Bejtexhinjve

Dihet se letërsia shqipe me alfabet arab, apo letërsia e bejtexhinjve, siç emërohet zakonisht në terminologjinë e ngulitur teorike e historike letrare, u shkrua në shekullin e 18 e 19; se vendi i zhvillimit të saj dhe i lulëzimit u bënë qendrat me zhvillim ekonomik e kulturor të lartë për kohën; se ajo u shkrua sipas modelit të letërsive të lindjes dhe se e përdori alfabetin e ardhur prej andej; se, me gjithë karakterin religjioz që e kishte, tipar dallues për krejt letërsinë e vjetër dhe mjaft shques për periudhat edhe të mëvonshme, dukshëm e pasuroi përmbajtjen e letërsisë shqipe me tema laike, sidomos me atë realiste; dhe se u dezintegrua si formë shkrimi atëherë kur në jetën shqiptare po tejkaloheshin interesimet dhe preokupimet lokaqe krahinore dhe fetare, për t’u zëvendësuar me idetë dhe preokupimet e përgjithshme kombëtare, në

¹⁵ Sabri Hamiti, “*Letërsia e vjetër shqiptare*”, Prishtinë, 2007, f. 89.

¹⁶ Sabri Hamiti, “*Letërsia e vjetër shqiptare*”, Prishtinë, 2007, f. 105.

¹⁷ Sabri Hamiti, “*Letërsia e vjetër shqiptare*”, Prishtinë, 2007, f. 114.

¹⁸ Sabri Hamiti, “*Letërsia e vjetër shqiptare*”, Prishtinë, 2007, f. 131.

¹⁹ Sabri Hamiti, “*Letërsia e vjetër shqiptare*”, Prishtinë, 2007, f. 143.

planin shoqëror, dhe me letërsinë e romantizmit, si letërsi gjithëkombëtare, në planin letrar. Mirëpo, për letërsinë me alfabet arab mund të thuhet edhe diçka më tepër se kaq.²⁰

Poezia me alfabet arab e shekullit 18

Poezia shqipe me alfabet arab u shkrua pra në shekullin 18; vazhdoi të shkruhet prej shumë autorëve edhe në shekullin e 19, atëherë kur letërsia e romantizmit dominonte si formacion historiko-letrar; dhe u shkrua edhe në pjesën e parë të shekullit 20, duke u vonuar kështu në kohë, por edhe duke u përligjur historikisht për këtë vonesë.

Të kësaj kohe, që mund të merret edhe si etapa e parë e poezisë shqipe me alfabet arab janë dy poetët e parë dhe të rëndësishëm të kësaj letërsie: Ibrahim Nezimi dhe Hasan Zyko Kamberi.

Poetë të tjerë të kësaj etape janë: Muçi Zade (Jug), Sulejman Naibi (Dervish Hasani (Krushë e vogël), Anonimi i Gjirokastrës (Gjirokastër), Mohall Hysejn Dobraçi (Shkodër), poezitë e të cilit nuk i kemi, ashtu siç nuk i kemi edhe të Ismail pashë Veleshtit, Hysen Efendi Shkodrës, Molla Sali Patës, poet satirik i oborrit të Bushatllijve, Sylejman pashë Elbasanit, Ibrahim Elbasanit, Sylejman Temanit (Berat), Omer Sadeddin Effendiut (Jug), Haxhi Ymer Kasharit (Tiranë), etj.²¹

Poezia me alfabet arab e shekullit 19

Autorët e kësaj periudhe, të njohur me veprimtarinë letrare paksa më të begatshme dhe më të ruajtur janë Tahir Efendi Boshnjaku (Gjakovë), Dervish Salihu (Lubizhdë-Has), Dalip Frashëri (Frashër), Sheh Jonuzi (Suhadoll-Mitrovicë), Baba Meleq Shemberdhenji (Skrapar). Të tjerët që mbahen mend me më pak krijime e deri te ata prej krijimtarisë së të cilëve ka mbetur vetëm nga një poezi janë të shumtë si Mulla Beqiri (Drenicë), Mulla Dervishi (Pejë), Hoxhë Dobi (Gjirokastër), Sheh Emini (Gjakovë), Muharrem Mahzuni Babi (Gjirokastër), Nesibeja e Gjirokastrës, Baba Abdullah Melqani (Gegëri), Baba Abidin Leskoviku (Leskovik), Baba Ibrahim (Kolonjë), Baba Salihu (Tepelenë), Sheh Hyseni (Prizren), Sheh Dalipi (Dibër), etj.²²

²⁰ "Poezia e Bejtexhinjve", UEGEN, Tiranë, 2010, f. 6.

²¹ "Poezia e Bejtexhinjve", UEGEN, Tiranë, 2010, f. 6.

²² "Poezia e Bejtexhinjve", UEGEN, Tiranë, 2010, f. 8.

Poezia me alfabet arab e shekullit 20

Poezia e kësaj etape është shkruar vetëm në Kosovë. Ku që nga viti 1912, kur, ndër të tjera, ndalohej përdorimi i lirë i gjuhës dhe i shkrimit të saj.

Krijuesit më të shquar të kësaj periudhe janë Sheh Mala (Rahovec), Vesel Guta (Zaskok-Ferizaj), Hysni Statovci (Batllavë-Llap), Dervish Veseli (Rahovec), Hafía Imer Shemalu (Prishtinë), Faik Efendi (Prishtinë), Dervish Idrizi (Gjakovë), Anonimi i Sheh Fejzullahit (Gramoqel-Gjakovë), Sheh Osmani (Junik), Shaip Zurnaxhiu (Rahovec), etj.²³

1.1.3 Letërsia e Rilindjes

Letërsia e Rilindjes kombëtare mbetet prej fillimeve e gjer në fund, ndonëse në dhjetëvjetëshat e fundit më aktivisht se në fillim, në shërbim të çështjes kombëtare dhe të interesave jetësore historike të popullit shqiptar.

Sigurisht për asnjë periudhë të letërsisë shqipe nuk është shkruar dhe diskutuar më shumë, si përpara ashtu edhe sot, se sa për periudhën e letërsisë së Rilindjes kombëtare dhe, sigurisht, për asnjë tjetër më tepër se për të nuk janë dhënë më shumë mendime të ndryshme dhe nuk kanë mbetur më shumë çështje të pazgjidhura.

Një numë shkrimtarësh shqiptarë që krijimtarinë e tyre letrare e fillojnë në dhjetëvjetëshin e fundit të kësaj lëvizjeje kombëtare, politike dhe letrare, por jetojnë e shkruajnë edhe mbas shpalljes së pavarësisë (Çajupi, Mjeda, Ndoc Nikaj, Fishta, Mihail Grameno, Faik Konica, Asdreni, Fan Noli dhe të tjerë), jo vetëm se nuk i shprehin disa prej karakteristikave, themelore të romantizmit, por në veprat e veta u japin shprehje edhe ca veçorive të tjera: naokasçite (Ndre Mjeda, Gjergj Fishta, Mihal Grameno), realiste: (Andon Zako Çajupi, Ndre Mjeda, Gjergj Fishta, Ndoc Nikaj, Asdreni), parnasiste-simboliste (Ndre Mjeda, Asdreni), që disa dekada përpara ishin shfaqur dhe afirmuar në letërsinë e popujve të mëdhenj evropianë.²⁴

Romantizmi në letërsi është shfaqur si pasojë e ndryshimeve të mëdha që po bëheshin në shoqërinë evropiane mbas tronditjeve ekonomike, sociale, politike, morale dhe të tjera, që kishte sjellë Revolucioni i madh francez.

²³ "Poezia e Bejtexhinjve", UEGEN, Tiranë, 2010, f. 8.

²⁴ Qosja Rexhep, "Letërsia e Rilindjes dhe romantizmi evropian", Prishtinë, 1975, f. f. 61-62.

Letërsia e Rilindjes kombëtare në krahasim me letërsinë e romantizmit evropian tregon shembëllesa e ndryshime edhe në pikëpamje të temave, motiveve, problemeve, që trajton, si dhe në pikëpamje të mënyrës së trajtimit të tyre.²⁵

Në letërsinë romantike të popujve të mëdhenj evropianë mund të flitet kryesisht, për dy brezni të romantikëve, kurse në letërsinë e Rilindjes kombëtare mund të flitet për tri brezni. Brezin e parë të rilindësve e përbëjnë De Rada, Zef Jubani dhe Jani Vreto; brezin e dytë Pashko Vasa, Zef Serembe, Gavril Dara (i Riu), Naim Frashëri, Sami Frashëri, e të tjerë; kurse brezin e tretë Filip Shiroka, Ndoc Nikaj, Andon Zako Çajupi, Ndre Mjeda, Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, Hilë Mosi, Asdreni e të tjerë, të cilët shënojnë fazën kalimtare mes letërsisë së Rilindjes dhe tendencave të tjera: realiste, neoklasiciste dhe simboliste të letërsisë shqipe.²⁶

1.1.4 Letërsia moderne shqipe

Periudha e *Letërsisë moderne shqiptare* njeh një zhvillim të paparë të të gjitha gjinive letrare, stileve individuale dhe të strukturave artistike. Kjo periudhë ka krijuar vlera antologjike të kësaj letërsie.²⁷

Edhe letërsia shqiptare e fillimeve të shekullit XX, doli si një frymë e re në raport me romantizmin dhe realizmin. Pikërisht në këtë periudhë kohore zuri fill edhe letërsia moderne shqiptare. Këto fille të shkëputjes nga parimet krijuese romantike në letërsinë tonë i gjejmë së pari te poezitë sociale dhe te komeditë e Çajupit. Pason proza kritike e Konicës. Qëndrimi kritik ndaj realitetit shoqëror konsolidohet plotësisht te satira fshikulluese e Fishtës dhe e Nolit, te proza sociale apo rrëfimet popullore të ritreguar të Mitrush Kutelit. Ndërkaq poezia e krijuar me një ndjesi të re e Asdrenit dhe e Poradecit, i bën ata figura të mëdha në këtë mozaik të larmishëm të letërsisë shqiptare moderne. Në këtë kohë pjesa më e madhe e këtyre autorëve përfaqësues të periudhës letrare jetonin në Shqipëri, shkrimet e tyre i botonin kryesisht në revista e në gazeta që dilnin brenda shtetit (por vazhdonin të botonin edhe jashtë shtetit), merrnin pjesë aktive në jetën politike, shoqërore e kulturore të vendit dhe ishin në rrjesha të drejtpërdrejta me rrymimet letrare të Evropës, sidomos të Italisë e të Francës. Në këtë periudhë u vunë po ashtu edhe bazat e studimit të letërsisë e të mendimit kritik për

²⁵ Qosja Rexhep, "Letërsia e Rilindjes dhe romantizmi evropian", Prishtinë, 1975, f. 77.

²⁶ Qosja Rexhep, "Letërsia e Rilindjes dhe romantizmi evropian", Prishtinë, 1975, f. 84.

²⁷ Sabri Hamiti, "Letërsia moderne shqipe", Prishtinë, 2005, f.13

letërsinë dhe artet përgjithësisht, kur u shquan sidomos Faik Konica, Fan Noli, Branko Merxhani, Mitrush Kuteli, Eqrem Çabej, Kristë Maloki, Vangjel Koça, Arshi Pipa, Qemal Draçini etj. Shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore dhe ngadhënjimi i komunikimit në Shqipëri preu si me shpatë zhvillimin normal të letërsisë moderne shqiptare dhe të mendimit për letërsinë. Regjimi komunist i ndoqi autorët përfaqësues të kësaj periudhe dhe veprat e tyre. Leximi i ndonjëres nga veprat e ndaluara ishte me rrezik të madh. Kështu disa nga autorët më në zë të kohës nuk patën si të bënin ndikim në letërsinë që do të krijohet pas Luftës.²⁸

1.1.5 Letërsia bashkëkohore

Letërsia bashkëkohore shqipe, si vazhdimësi e natyrshme e modernes, diferencohet si e këtillë nga fillimi i viteve '50 të shekullit XX. Ajo vjen si vazhdimësi e traditës sonë letrare, me mbështetje në krijimtarinë gojore, por edhe në modelet e autorëve të njohur të letërsisë moderne shqiptare dhe të asaj botërore. Duke frymuar me kohën, kjo letërsi për një kohë relativisht të gjatë u zhvillua sipas metodës së realizmit socialist, e cila ishte inauguruar së pari në Rusi, e të cilën e karakterizon shprehja dogmatik dhe më e kufizuar. Në Shqipëri fryma e kësaj metode mbizotëroi deri në fillim të viteve '90, kur ra sistemi komunist, kurse në Kosovë largimi nga ajo u bë më herët.²⁹

Letërsinë shqipe të kësaj periudhe e karakterizon shprehja më e lirë, përmbajtjet dhe format e reja, moderne, në hap me letërsitë e tjera.

Në letërsinë bashkëkohore shqipe kultivohen të gjitha gjinitë dhe llojet letrare. Krijuesit e letërsisë bashkëkohore sjellin forma të reja të shprehjes në të gjitha llojet letrare, arrijnë të zhvillohen dhe të konsolidohen edhe romani shqiptar, tregimi e novela, të cilat në të kaluarën sikur kishin ngecur në krahasim me poezinë.

Autorët që e përparuan shprehjen poetike në letërsinë tonë të sotme janë: Martin Camaj, Esat Mekuli, Enver Gjerqeku, Fahredin Gunga, Ali Podrimja, Dritëro Agolli, Ismail Kadare, Din Mehmeti, Fatos Arapi, Rrahman Dedaj, Azem Shkreli, Sabri Hamiti, Eqrem Basha, Xhevahir Spahiu, Bardhyl Londo etj.; në prozë janë: Jakov Xoxa, Anton Pashku, Ismail Kadare, Kasëm Trebeshina, Fatos Kongoli, Zejnullah Rrahmani Mehmet Karaja etj.; në dramë shquhen

²⁸ Sabri Hamiti, *"Letërsia moderne shqipe"*, Prishtinë, 2005, f.90.

²⁹ Demolli Arif, Sylja Xhevat, *"Leximi letrar 9"*, Prishtinë, 2016, Libri shkollor, f. 130

autorët: Etëhem Haxhiademi, Anton Pashku, Kolë Jakova, Rexhep Qosja, Kasëm Trebeshina, Teki Dervishi, Ymer Shkreli etj.³⁰

Në këtë periudhë u shënuan arritje të mëdha edhe në fushën e studimeve dhe të mendimit kritik për letërsinë, ku shquhen sidomos Dhimitër Shuteriqi, Rexhep Qosja, Ibrahim Rugova, Sabri Hamiti, Agim Vinca, Aurel Plasari, Kujtim M. Shala, Kujtim Rrahmani, Ag Apolloni e të tjerë.

Në të gjitha këto lloje të krijimtarisë kemi individualitete të formuara letrare, që krijuan vepra me vlera të qëndrueshme artistike.³¹

³⁰ Ali Aliu, Shaban Sinani, Stefan Çapaliku, Tonin Çobani, *“Letërsia bashkëkohore shqiptare”*, Prishtinë, 2001, f. 43.

³¹ Ali Aliu, Shaban Sinani, Stefan Çapaliku, Tonin Çobani, *“Letërsia bashkëkohore shqiptare”*, Prishtinë, 2001, f. 45.

KAPITULLI II

2. Letërsia e sotme shqipe

Letërsia e sotme shqipe, si vazhdimësi e natyrshme e modernes, diferencohet si e këtillë nga fillimi i viteve '50 të shekullit XX. Ajo vjen si vazhdimësi e traditës sonë letrare, me mbështetje në krijimtarinë gojore, por edhe në modelet e autorëve të njohur të letërsisë moderne shqiptare dhe të asaj botërore. Duke frymuar me kohën, kjo letërsi për një kohë relativisht të gjatë u zhvillua sipas metodës së realizmit socialist, e cila ishte inauguruar së pari në Rusi, e të cilën e karakterizon shprehja dogmatik dhe më e kufizuar. Në Shqipëri fryma e kësaj metode mbizotëroi deri në fillim të viteve '90, kur ra sistemi komunist, kurse në Kosovë largimi nga ajo u bë më herët.

Sado që një kohë relativisht të gjatë kjo letërsi u zhvillua në rrethana të difavorshme politike, pa qarkullim të lirë të njerëzve dhe të vlerave në mbarë hapësirën kombëtare, shkrimtarët tanë arritën të krijojnë vlera të reja, të qëndrueshme dhe të shprehnin gjendjen dhe disponimin e njeriut tonë me ëndrrat, dëshirat dhe synimet e tij shekullore.

Letërsinë shqipe të kësaj periudhe e karakterizon shprehja më e lirë, përmbajtjet dhe format e reja, moderne, në hap me letërsitë e tjera. Derisa letërsia e realizmit socialist në çdo përmbajtje para se gjithash kërkonte elementin ideologjik, në letërsinë bashkëkohore kemi një liri më të madhe të shprehjes së gjithë asaj që është ndjenjë dhe gjendje reale shpirtërore e njeriut, që është synim, dëshirë dhe vizion i tij. Krijuesit e letërsisë bashkëkohore sjellin forma të reja të shprehjes në të gjitha llojet letrare, arrijnë të zhvillohen dhe të konsolidohen edhe romani shqiptar, tregimi e novela, të cilat në të kaluarën sikur kishin ngecur në krahasim me poezinë. Duke u mbështetur në frymën që kishte futur në letërsinë tonë poezia e Migjenit, si dhe në vlerat e tjera të traditës sonë letrare, poezia e përparoi edhe më shumë shprehjen e saj duke u bërë përherë e më metaforike dhe duke qenë gjithnjë më afër strukturave dhe modeleve botërore të kohës.³²

Në letërsinë e sotme shqipe kultivohen të gjitha gjinitë dhe llojet letrare.

³² Demolli Arif, Sylva Xhevat, "Leximi letrar 9", Prishtinë, 2016, Libri shkollor, f. 130

Autorët që e përparuan shprehjen poetike në letërsinë tonë të sotme janë: Martin Camaj, Esat Mekuli, Enver Gjerqeku, Fahredin Gunga, Ali Podrimja, Dritëro Agolli, Ismail Kadare, Din Mehmeti, Fatos Arapi, Rrahman Dedaj, Azem Shkreli, Sabri Hamiti, Eqrem Basha, Xhevahir Spahiu, Bardhyl Londo etj.; në prozë janë: Jakov Xoxa, Anton Pashku, Ismail Kadare, Kasëm Trebeshina, Fatos Kongoli, Zejnullah Rrahmani Mehmet Karaja etj.; në dramë shquhen autorët: Etëhem Haxhiademi, Anton Pashku, Kolë Jakova, Rexhep Qosja, Kasëm Trebeshina, Teki Dervishi, Ymer Shkreli etj.³³

Në këtë periudhë u shënuan arritje të mëdha edhe në fushën e studimeve dhe të mendimit kritik për letërsinë, ku shquhen sidomos Dhimitër Shuteriqi, Rexhep Qosja, Ibrahim Rugova, Sabri Hamiti, Agim Vinca, Aurel Plasari, Kujtim M. Shala, Kujtim Rrahmani, Ag Apolloni e të tjerë.

Në të gjitha këto lloje të krijimtarisë kemi individualitete të formuara letrare, që krijuan vepra me vlera të qëndrueshme artistike.³⁴

Shkaku më i dukshëm i një vepre arti është krijuesi i saj, autori; prandaj dhe trajtimi sipas personalitetit dhe të jetës së shkrimtarit ka qenë një nga metodat më të hershme e më të afirmuara të studimeve letrare. Për biografinë mund të flitet e të gjykohet për aq sa hedh dritë vetë veprën e artit; por natyrisht ne e mbrojmë dhe e përligjim biografinë edhe si një studim për gjeniun dhe talentin, për zhvillimin e tij moral, intelektual dhe emocional dhe kjo ka interesin e vet të brendshëm; më në fund themi se biografia jep materiale për një studim sistematik të psikologjisë së shkrimtarit dhe të vetë procesit krijues.³⁵

Prandaj, në këtë kapitull do t'i trajtojmë edhe disa prej autorëve të letërsisë së sotme shqipe, lidhur me jetën e këtyre autorëve dhe veprat e tyre, gjë që do të jetë e rëndësishme që të trajtohen.

³³ Ali Aliu, Shaban Sinani, Stefan Çapaliku, Tonin Çobani, *"Letërsia bashkëkohore shqiptare"*, Prishtinë, 2001, f. 43.

³⁴ Ali Aliu, Shaban Sinani, Stefan Çapaliku, Tonin Çobani, *"Letërsia bashkëkohore shqiptare"*, Prishtinë, 2001, f. 45.

³⁵ Rene, W., Austin, W., *"Teoria e letërsisë"*, Tiranë, 2007, f. 75.

2.1 Autorët e letërsisë së sotme shqipe

Petro Marko

Në moshën 78-vjeçare (1991) vdiq shkrimtari i njohur *bashkëkohor shqiptar*, Petro Marko. Petro Marko është krijues që përjetoi mjerimin dhe varfërinë, kurbetin dhe mërgimin; burgjet dhe internimin; ndjekjet dhe persekutimin; që mori pjesë në dy revolucione dhe që, pavarësisht nga mënyra e dënimit që pësoi, mbeti tërë jetën një idealist i devotshëm.³⁶

Hapat e para në krijimtari i bëri qysh në fillim të viteve '30 me poezi, prozë të shkurtër e publicistikë, duke bërë emër në mesin e krijuesve e intelektualëve të rinj e përparimtarë të kohës.

Petro Marko si njeri dhe shkrimtar e karakterizon humanizmi i thellë, shpirti liridashës, dashuria ndaj popullit të vet dhe mbarë njerëzimit, përkushtimi ndaj atdheut – si parime jetësore e krijuese, por edhe morali i lartë, ndershmëria, krenaria dhe fisnikëria – si tipare të karakterit.³⁷

Petro Marko i takonte kategorisë së shkrimtarëve që shkruajnë relativisht shumë dhe shpejt. Botoi një varg romanesh, por shkroi edhe drama, tregime, skica, reportazhe, letërsi për fëmijë e të rinj etj. Romanet e tij: *Hasta la vista* (1958), *Qyteti i fundit* (1969), *Stina e armëve* (1966), *Ara në mal* (1968), *Ultimatum* (1972), *Nata e Ustikës* (1989) etj., i venë bazat e romanit shqiptar të pasluftës dhe i hapin horizonte të reja këtij zhanri të ri e deficitar në letërsinë shqipe.

Krijimtaria poetike e Petro Markos përmbledhet në një vëllim të vetëm: në vëllimin me titull *Horizont*, të botuar në vitin 1959.³⁸

Ismail Kadare

Lindi në Gjirokastrë (1936) është shkrimtari më i madh *bashkëkohor shqiptar*, vepra e të cilit është përkthyer në shumë gjuhë të botës. Aty e mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm, ndërsa studimet i mbaroi në Fakultetin Histori-Filologji të Tiranës. Studioi në Institutin “Gorki” të Letërsisë Botërore në Moskë.

³⁶ Filip Ndocaj, “Petro Marko: poeti, publicisti dhe romancieri ynë...”, Nëntori, 1973, f. 11.

³⁷ Vinca Agim, “Alternativa letrare shqiptare”, Shkup, 2005, f. 150.

³⁸ Vinca Agim, “Alternativa letrare shqiptare”, Shkup, 2005, f. 156.

Ismail Kadare shkroi dhe botoi një numër të madh të veprave letrare. Shkroi kryesisht për të rritur, por janë të njohura edhe disa vepra të tij për fëmijë. Veprat e tij janë përkthyer në shumë gjuhë të botës. Vetëm romani “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” është përkthyer në më shumë se pesëdhjetë gjuhë. Vepra të tij më të njohura janë: “Princesha Argjiro”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Motive me diell”, “Kështjella”, “Kronikë në gur”, “Autobiografia e popullit në vargje”, “Emblema e dikurshme”, “Ura me tri harqe”, “Gjakftohtësia”, “Koncert në fund të dimrit”, “Eskili, ky humbës i madh”, “Pallati i ëndrrave”, “Stinë e mërzitshme në Olimp”, “Hija”, etj.

Ismail Kadare ka disa vjet që është kandidat për Çmimin Nobël për letërsi.

Miti i kështjellës

Çdo popull gjatë qëndresës së vet në këmbë dhe në jetë, gjatë ngarendjes për ekzistencë dhe në vetë ecjet e veta në kohë, ka krijuar një mit. Populli shqiptar e ka krijuar mitin e qëndresës në mendjet e bijve të tij të gjallë dhe të vdekur. Ky element i jetës, i ngritur në lartësinë e mitit, në rrjedhën e kohës ka qenë aq tepër i lidhur me vendin ku është bërë qëndresa sa që rrallëkush do të ketë qitur fjalë në jetë ose në vepër letrare mbi qëndresën e popullit tonë e të mos ta ketë përmendur tok me këtë edhe kështjellën dhe kullën. Ismail Kadare e ka vënë në thelb të romanit të tij më të ri këtë element me moshë të madhe kombëtare, që u zgjat në perin e kohës deri në ditët e së sotmes. Pra, në kulm të romanit e ka vënë një kështjellë shqiptare, e cila me kuptimin e saj simbolik shtrihet në të katër anët e horizontit kombëtar dhe pa vështirësi i kalon edhe këta kufij.³⁹

Simbolika e shiut

Ismail Kadare është njëri ndër shkrimtarët tanë më në që që gjatë thurjes së veprave të veta, qofshin këto të shkruara në poezi apo në prozë, e përqaftuar edhe fenomenin natyror si një aleat besnik, herë për të konkretizuar kuptime jetësore, herë për të bërë zgjatjen simbolike të një veprimi në kohë. Njëri ndër fenomenet natyrore që ka marrë kuptim plotësisht të organizuar në veprën e tij letrare është fenomni i shiut. Shiun e ndeshim si element stilistik dhe artistik në romanin e tij të parë *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, e ndeshim në romanin e tij të dytë, *Dasma*, edhe në romanin e tij të tretë, *Kështjella*. Në këtë të fundit shiu ka marrë një kuptim të organizuar simbolik dhe është i përbërë prej dy anësh, dy elementesh kuptimore: shiu që e

³⁹ Hamiti Sabri, “*Letërsia bashkëkohore*”, Vepra letrare 9, Prishtinë, 2002, f. 71.

sjell humbjen, frikën, dyshimin e dhembjen, në një rën anë, dhe shiu që sjell pjellorinë tokësore, dritën e shpëtimit, gazin dhe lirim në anën tjetër.⁴⁰

Dritëro Agolli

Dritëro Agolli (13 tetor 1931 - 3 shkurt 2017) - poet, prozator, publicist dhe politikan shqiptar, është poeti më i shquar i *letërsisë së sotme bashkëkohore*. Dritëro Agolli lindi më 13 tetor 1931 në Menkulas të Rrethit të Devollit afër Korçës dhe u nda nga jeta më 3 shkurt 2017 në Tiranë (në moshën 85 vjeçare ndahet nga jeta me një sëmundje kronike në mushkri por, ai do të mbetet një nga figurat më të shquara të penës shqiptare). Pasi mori mësimet e para në vendlindje, vazhdoi gjimnazin e Gjitokastrës, një shkollë me mjaft traditë. Ai vazhdoi studimet e tij në Fakultetin e Arteve në Shën Petersburg. Ka punuar shumë kohë gazetar në gazetën e përditshme "*Zëri i popullit*", dhe për shumë vjet ka qenë Kryetar i *Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë*. Për tridhjetë vjet me radhë Dritëro Agolli u zgjodh deputet. Krijimtaria e tij letrare është mjaft e pasur në gjini e lloje të ndryshme: poezi, poema, tregime, novela, romane, drama, skenarë filmash etj. Është fitues i disa çmimeve dhe i nderimeve të tjera. Disa prej veprave më të rëndësishme të tij janë përkthyer në Perëndim e në Lindje.⁴¹

Vepra letrare e Dritëro Agollit krijoi traditën e re të letërsisë shqiptare. Ajo na bën të ndihemi me dinjitet përballë botës së madhe. Shkrimtar i madh i një "gjuhe të vogël", ai është po aq i dashur prej lexuesve bashkëkombës, sa edhe në metropolet e kulturës botërore. Dritëro Agolli dhe brezi i tij letrar (vitet '60) nuk u paraqitën me ndonjë poetikë të re, sido që u diskutua mjaft edhe për rimën dhe ritmin, për vargun e lirë dhe vargun e rregullt, për "rreptësinë" e poezisë.⁴²

Dritëro Agolli është poet që e karakterizon para se gjithash prirja për ta kapur jetën në lëvizje dhe për të zbuluar momentet poetike të realitetit, anët me potencë ideoemocionale e filozofike. Në vjershën "*Kur libri është në shtyp*" ai tregon se si poeti nuk është i qetë as kur e dorëzon librin në shtyp, sepse para syve të tij ndodhin shumë gjëra, të vogla e të mëdha. Para syve të poetit ndodh jeta, të cilën ai dëshiron ta transponojë në poezi: diku ngrihet një

⁴⁰ Hamiti Sabri, "*Studime letrare*", Prishtinë, 2003, f. 562.

⁴¹ https://sq.wikipedia.org/wiki/Drit%C3%ABro_Agolli#cite_note-2 (qasja e fundit më 10.10.2018)

⁴² Kuçuku, B., "*Bota poetike e Dritëro Agollit*", në revistën Studime filologjike, 1991/1, f. 151-160.

digë betoni, në një fshat elektrikisti llambën e fundit lidh, diku në një rrugë një vajzë ecën e dashuruar, në një fushë lule mbush kërcellin me fletë.⁴³

Titujt e veprave: Në rrugë dola, 1958, Hapat e mia në asfalt, 1961, Zhurma e erërave të dikurshme, 1964, Shtigje malesh dhe trotuare, 1965, Mesditë, 1969, Komisari Memo, roman, 1969, Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo, roman, 1973, Njeriu i mirë, tregime, 1973, Nënë Shqipëri, 1974, Njeriu me top, 1975, Fjala gdhend gurin, 1977, Trëndafili në gotë, roman, 1980, Fytyra e dytë, dramë, Mosha e bardhë (dramë), Udhëtoj i menduar, 1985, Pelegrini i vonuar, 1993, Kalorësi lakuriq, roman, 1996, Vjen njeriu i çuditshëm, poezi, 1996, Arka e djallit, roman, 1997, Teshtimat e lirisë: njeriu, politika dhe kultura, 1997, Fletorka e mesnatës, 1998, I përndjekuri i dashurisë, poezi, 2013, Prit edhe pak, poezi, 2016, E bukura, lozonjarja, tokësorja Grua, poezi, 2017, Nulla dies sine linea, aforizma, 2017.⁴⁴

Anton Pashku

Lindi në fshatin Grazhdanik të Hasit të Thatë të Pirenit (1937-1995). U shkollua në Prizren dhe në Prishtinë. Punoi gazetar e redaktor i rubrikës së kulturës në gazetën “Rilindja”. Pataj deri në fund të jetës qe redaktor në edicionin e botimeve të “Rilindjes”, ku redakttoi qindra libra të shkrimtarëve tanë dhe të huaj.

Anton Pashku, pa dyshim, është njëri prej shkrimtarëve tanë të brezit të ri, i cili që prej fillimit të krijimtarisë së tij letrare ka hasur në mirëkuptimin e kritikës, duke gëzuar ashtu përkrahjen e saj, pavarësisht pse një mirëkuptim i tillë nga ana e lexuesve shpeshherë i ka munguar. Megjithëse ka filluar të shkruajë mjaft i ri, që nga bankat e shkollës së mesme, prozat e tij, të botuara, kryesisht, në revistën letrare *Jeta e re*, që në fillim kanë dëshmuar një nivel artistik, që vetëm rrallë e tek mund të hasej në prozën tonë dhe një përvojë krijuese, jo të shpeshtë tek shkrimtarët e asaj moshe.⁴⁵

Duke filluar prej përmbledhjes së parë, *Tregimet* (1961), proza e Anton Pashkut gjithnjë e më dukshëm i manifeston specifikat e veta tematike, stilistike dhe artistike, që në përmbledhjet e mëvonshme të tregimeve *Nji pjesë e lindjes* (1965), *Kulla* (1968) dhe, në mënyrë të veçantë, në dramën *Sinkopa* (1969), dhe në prozën e gjatë *Oh* (1971) edhe më tepër artikullohet. Anton

⁴³ Vinca, A., “Orët e poezisë”, Prishtinë, 2010, fq. 157.

⁴⁴ https://sq.wikipedia.org/wiki/Drit%C3%ABro_Agolli#cite_note-GjSh-4 (qasja e fundit më 23.10.2018)

⁴⁵ Qosja, R., “Prej letërsisë romantike deri te letërsia moderne”, Prishtinë, 2006, f. 483.

Pashku gjithsesi nuk hyn në radhën e prozatorëve që frymëzohet prej ngjarjeve të përditshme, të zakonshme jetësore, ai është prozator që trajton situata, probleme, çështje të rralla, gati të jashtëzakonshme, disi të çuditshme. Veprat e tjera janë: *Kjasina* (1973), *Gof* (1976) dhe *Lutjet e mbrëmjes* (1978).⁴⁶

Anton Pashku ka shkruar një numër prozash e, sidomos, tregimesh, që e radhisin ndër tregimtarët e dalluar të **letërsisë së sotme shqipe**. Të tilla do të ishin tregimet *Kulla*, *Nuk e dij pse tha se ky rrëfim asht fantastik*, *Kënaqësitë e Magalopolisit*, *Vdekja solemne*, *Si e përshkroi andrrën e vet njeriu me kapelë*, *Floçka* dhe *Anija e dejun*.⁴⁷

Ali Podrimja

Lindi në Gjakovë (1942-2012) është njëri ndër poetët *shqiptarë bashkëkohorë* më në zë. Aty mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm, ndërsa fakultetin për gjuhë dhe letërsi shqipe e kreu në Universitetin e Prishtinës. Që i ri merret me krijimtari letrare. Poezinë e parë e botoi më 1957 në revistën “Jeta e re”, ndërsa përmbledhjen e parë me poezi “Thirrje” e botoi më 1961. Pastaj botoi edhe librat e tjerë me poezi, si *Dhimbë e bukur* (1967), *Sampo* (1969), *Torzo* (1971), *Folja* (1973), *Credo* (1976), *Sampo 2* (1980), *Drejtpeshimi* (1981), *Lum Lumi* (1982), *Fund i gëzuar* (1988), *Zari* (1990), *Në bisht të zorrës* (1994), *Buzëqeshje në kafaz* (1995), *Ishulli Albania*, *Pikë e zezë në blu* (2005) etj.

Tema e simbola

Ali Podrimja e ka botuar vjershën e parë më 1957, në revistën letrare “Jeta e re”, këtu e pesëmbëdhjetë vite më parë. Gjatë punës së frytshme krijuese prej një dhjetëvjetëshi, ai ka pasur disa kthesa të shënueshme në krijim. Gjatë kësaj kohe, edhe pse jo të gjatë, poeti ka kaluar nëpër katër faza krijimi, që shënohen me katër përmbledhje të tijat: 1. *Hija e tokës*; 2. *Sampo*; 3. *Torzo*; 4. *Zoo (në dorëshkrim)*.

1. Hija e tokës

Në *Hija e tokës* shpërthen poeti, i cili e ka pasur fatin e vështirë të të jatit dhe të gjyshit, ndaj e këndon këtë si bir i tretë, si bir i dhjetë, i vuajtjes dhe i mjerimit. Ky është fati i njeriut, që

⁴⁶ Qosja, R., “Prej letërsisë romantike deri te letërsia moderne”, Prishtinë, 2006, f. 485.

⁴⁷ Qosja, R., “Prej letërsisë romantike deri te letërsia moderne”, Prishtinë, 2006, f. 512.

me të lindur është i dënuar të jetojë dhe të luftojë kundër *zot – njeriut – pushtues* që pushton mbi koka.⁴⁸

2. Sampo

Ajo që e dallon, në të parë, këtë përmbledhje nga Hija e tokës, është zgjerimi i interesimeve poetike të autorit, kështu që edhe vetë përmbledhja del më e kompletuar dhe më mirë e organizuar kuptimisht. Janë prekur shumë anë të jetës dhe të vetë njeriut edhe nga e jashtmeja, edhe nga e brendshmeja.⁴⁹

3. Torzo

Në këtë vëllim hyjnë poezitë më të mira që i ka krijuar Ali Podrimja. Nga vjershat e para, që janë si shprehje e reagimeve subjektive ndaj fenomeneve jetësore përreth dhe shprehje e këndimeve plot entuziazëm, e dhembjeve për humbjet, arrijmë te poezia e cila krijohet shpesh e shpesh rreth një ideje, apo një problemi të njeriut, duke përcjellë kuptimin e tij në rrjedhë të kohës, siç janë, tradhtia, dashuria, qëndresa, përlulja, etj.⁵⁰

4. Zoo (Dorëshkrim)

Poezia e këtij vëllimi e ka shpallur njeriun nga brenda, duke ia analizuar këtij veprimet, sjelljet dhe reagimet në lidhje me marrëdhëniet me njerëzit e rrethit të tij dhe me vetë problemin e njeriut në përgjithësi.⁵¹

Esat Mekuli

Esad Mekuli lindi në Plavë e vdiq në Prishtinë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Pejë. Ka studiuar në Zagreb, në Beograd e në Itali. Pas studimeve u doktorua në fushën e veterinarisë, por gjatë gjithë jetës u mor me letërsinë e kulturën.

Të gjitha veprat e tij letrare janë në poezi: *Për ty* (1955), *Drita e re* (1966), *Avsha Ada* (1973), *Brigjet* (1981), *Rini e kuqe* (1984), *Drita që nuk shuhet* (1989).

⁴⁸ Hamiti Sabri, “*Letërsia bashkëkohore*”, Vepra letrare 9, Prishtinë, 2002, f. 171.

⁴⁹ Hamiti Sabri, “*Letërsia bashkëkohore*”, Vepra letrare 9, Prishtinë, 2002, f. 175.

⁵⁰ Hamiti Sabri, “*Letërsia bashkëkohore*”, Vepra letrare 9, Prishtinë, 2002, f. 173.

⁵¹ Hamiti Sabri, “*Letërsia bashkëkohore*”, Vepra letrare 9, Prishtinë, 2002, f. 177.

Esat Mekuli është marrë gjatë tërë jetës me përkthime letrare. Ka përkthyer me dhjetëra vepra në gjuhën shqip, zakonisht në serbokroatishte.⁵²

Vjershat e hershme të Esat Mekulit i shprehin problemet sociale nëpërmjet një trajte metaforike që është edhe mbrojtje nga cenzura e tmerrshme për autorët shqiptarë. Ai shkruan vjersha të fuqishme të ambientit, ku peisazhi merr funksionin e paraqitjes së gjendjes shpirtërore dhe figurimin e ideve kryesore.⁵³

Vepra e tij poetike kalon nëpër tri kohë të shqiptarëve të Kosovës: para Luftës së Dytë, kur ishte e ndaluar të shkruhej shqip; gjatë luftës, kur rritej iluzioni se do të fitoheshin të drejtat; dhe pas luftës, kur diçka u fitua, por edhe u shprish iluzioni për lirinë e synuar. Poezia e tij, që emocionalisht i përcjell këto zhvillime, ka marrë pamje të ndryshme të ideve në faza të ndryshme.

Pa marrë parasysh që shkroi poezi gjatë tërë jetës, vepra e parë *Për ty* (1955), që përmbledhte poezitë e rinisë së tij, mbetet më e mira e themelorja dhe e përcakton vlerën e tij poetike, individualitetin e tij poetik.⁵⁴

Për ty

Autori librin e ndan në tri tërësi me kriter kronologjik të shkrimeve: *Në hijen e robnis* (1933-1940), *Flamujt e shpaluëm* (1941-1944) dhe *Jeta e Re* (1945-1953). Vetë titujt e këtyre kapitujve poetikë tregojnë që emërtimet lidhen me një ide të zhvilluar në tri kohë për lirinë e popullit të tij. Dhe natyrisht në ballë të këtyre kapitujve del poezia e veçantë *Popullit tim*.⁵⁵

Zef Zobra

Lindi më 1920 në Kotorr të Malit të Zi në një familje shqiptare. Mbas mbarimit të gjimnazit në Shkodër, më 1941 regjistrohet në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, dega e Studimeve Politike në Universitetin e Padovas në Itali. I ndërpret studimet më 1943 për shkak të Luftës së Dytë Botërore dhe kthehet në Shkodër, ku fillon punën si nëpunës banke. Në vitet 1945-1946 punësohet si regjisor në Shtëpinë e Kulturës së Shkodrës, ku vë në skenë mjaft pjesë dramatike me tingëllim të qartë desident si "Juda Makabe" e Fishtës, "Armiku i Popullit"

⁵² Hamiti Sabri, "Letërsia bashkëkohore", Vepra letrare 9, Prishtinë, 2002, f. 23.

⁵³ Hamiti Sabri, "Letërsia bashkëkohore", Vepra letrare 9, Prishtinë, 2002, f. 33.

⁵⁴ Hamiti Sabri, "Letërsia bashkëkohore", Vepra letrare 9, Prishtinë, 2002, f. 24.

⁵⁵ Hamiti Sabri, "Letërsia bashkëkohore", Vepra letrare 9, Prishtinë, 2002 f. 25.

i Ibsenit etj. Ndoshta edhe për këtë arsye arrestohet më 1946 dhe burgoset nën akuzën e agjitacion e propagandës. Vuan dënimin ndër kampet e punës dhe "riedukimit" deri në vitin 1951. Më vonë punon në ndërmarrje të rrethit të Shkodrës si logaritar deri në vitin 1980, kur dhe del në pension. Ndërron jetë në janar 1993 në Shkodër.⁵⁶

Zbulimi i Zef Zobrës poet, pra, lëkund kaq shume evidenca, si shenja kolektive të sjelljes dhe kaq kërkime personale, si krijime individuale në shqip.

Zef Zobra ka lindur në Kotorr të Malit të Zi më 1920 e ka vdekur në kallnor të vitit 1993 në Shkodër. Gjimnazin e ka mbaruar në Shkodër, kurse nga viti 1941 në Universitetin e Padovas në Itali ka nisur Studimet Politike në Fakultetin e Shkencave Shoqërore.⁵⁷

Shënime për librin e poezisë

Libri i poezisë *Buzë të ngrira në gaz* dhe zbulimi i tij është hyrje në zgjidhjen e enigmës së poezisë moderne shqipe, që është edhe zgjidhje e enigmës së autorit, që zgjatë gjysmë shekulli.

Vjersha e parë e librit ka titullin “Në vend të hyrjes”.

- Cikli i parë “Elemente” ka 13 poezi.
- Cikli i dytë “Blerime tjera e zalle” ka 19 poezi.
- Cikli i tretë “Pasqyra të cfilitura” (të fillimeve të fundit) ka 19 poezi.
- Cikli i katërt “Fuga e fundit” ka 5 poezi.
- Cikli i pestë është poema “Mbresa e rrugëve”.
- Cikli i gjashtë “Në zgrip” ka 6 poezi.

Në fund të cikleve të poezive shkruan “Fund 1945-1980”.

Teki Dervishi

Teki Dervishi lindi më 16 Janar 1943 në Gjakovë dhe vdiq me 29 qershor 2011 në Prishtinë. Është shkrimtar dhe publicist shqiptar nga Kosova. Deri në vdekjen e tij ishte drejtor i gazetës ditore "Bota Sot". Pas shkollimit fillor ai i ra në sy regjimit serb të asaj kohe dhe u burgos e u dënua që në moshën 17 vjeçare, ku vuajti dënimin disavjeçar në burgjet serbe. Teki Dërvishi

⁵⁶ https://sq.wikipedia.org/wiki/Zef_Zorba (qasja e fundit më 02.01.2019).

⁵⁷ Hamiti Sabri, “*Letërsia bashkëkohore*”, Vepra letrare 9, Prishtinë, 2002, f. 46.

është ndër të burgosurit më të rinj shqiptar që vuajti në burgun famëkeq jugosllav të Goli Otokut.

Teki Dervishi gjatë gjithë jetës së tij u mor me shkrime letrare e publicistike. Është autor i rreth 90 veprave letrare artistike, romane, poezi, drama. Është autor i romaneve: Pirgu i Lartë, 1972, Padrona, 1973, Skedarët. 1974, Herezia e Dervish Mallutës, 1981, Palimpsest për Dush Kusarin, 1993. I përmbledhjes së tregimeve: Etje dhe Borë, I vëllimit të poezive Nimfa 1970, Shtëpia e Sëmurë 1978, Thashë 1981, Nimfa 1986. Ka botuar edhe këto drama: Zbutësi i njerëzve me sy prej zymrydi, 1979, Bregu i Pikëllimit, 1985, Pranvera e Librave, 1990, Zhvarrimi i Pjetër Bogdanit, 1990, Kufiri me atdhe, 1996, Vojceku, 1996, Eshtrat që kthehen vonë, 2000, Nesër nisemi për Parajsë, 1999, Ku është Populli?, 2003 si dhe i veprës me ese e kritika mbi teatrin Qan e qesh Talia 1978.⁵⁸

Teki Dervishi u shfaq në letërsinë shqipe në fillim të viteve gjashtëdhjetë me tregime të shkurtra, që i karakterizonte një emocionalitet dhe kërkimi në rrjedhat sociopsikologjike të njeriut dhe të ambientit. Në vijim gjithë krijimtarinë e tij letrare të shfaqur në trajtën e poezisë, të prozës e të dramës, e karakterizon konstanta e lirizmit. Ai ngre një teori mbi artin si një solemnitet që ndërtohet përtej jetës, që për pasojë sjell mitizmin dhe mistifikimin e krijuesit.

Teki Dervishi është i njohur në *letërsinë e sotme shqipe* me vepra dramatike, të cilat janë luajtur me sukses në skenat e teatrove shqiptare në Prishtinë, në Shkup e në Tiranë. Edhe ndërtimet e këtij autori ngjiten në trashëgiminë e tij letrare në poezi e në prozë, duke ruajtur në mënyrë të habitshme edhe lirizmin edhe rrëfimin.

Vepra *Zbutësi i njerëzve* situon e dramatizon teorinë e dhunës të mistifikuar e në mënyrë alegorike. *Vepra Bregu i pikëllimit* në nëntë variante kërkon situatat e krijimit, rrezikimit dhe të mbrojtjes së individualitetit, i cili në veprën e Teki Dervishit gjithmonë shfaqet në trajtën e krijuesit autentik. Kurse vepra *Zhvarrimi i Pjetër Bogdanit* edhe një herë e ndërton krijuesin si hero kulturor, tani të gjetur në trashëgiminë e kulturës shqipe.⁵⁹

⁵⁸ https://sq.wikipedia.org/wiki/Teki_Dervishi (qasja e fundit më 09.12.2019)

⁵⁹ Hamiti Sabri, “*Letërsia bashkëkohore*”, Vepra letrare 9, Prishtinë, 2002, f. 288.

Jusuf Gërvalla

(Dubovik, 1 tetor 1943 - Shtutgart, 18 janar 1982) ka qenë veprimtar, shkrimtar dhe muzikant shqiptar. Ka qenë themelues i grupit marksist-leninist Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës. Lindi në Burrëmadhi, në komunën e Deçanit. Shkollimi i lartë tij vijoi në Prishtinë e Ljubjanë, më pas punoi si gazetar në Shkup e Prishtinë. Një nacionalist i zëshëm, hyri në radarin e Policisë sekrete jugosllave, duke u shtytur të kërkonte azil në Gjermani ku themeloi Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës që më pas u nda në dy fraksione Lëvizja Popullore e Kosovës dhe Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës, të mbaramin e kryesonte Gërvalla.

Më 18 janar 1982 Jusufi bashkë me të vëllanë, Bardhoshin, dhe Kadri Zekën u vranë nga shërbimi sekret Jugosllave në lokalitetin Untergruppenbach pranë Shtutgartit në Gjermaninë Perëndimore asokohe.⁶⁰

Krijimtaria letrare e Jusuf Gërvallës u zhvillua vrullshëm brenda viteve '70, ndoshta edhe më ngushtë në kohë, siç ngjet gati gjithnjë me krijuesit të cilëve parashenjat e brendshme u thonë se shpejt vjen fundi, se *njeriu vdes i ri*, le të më lejohet kjo figurë imja e vjetër. Edhe pse krijimtaria e tij, bashkë me jetën, u këput tragjikisht, ai la këto vepra:

1. Fluturojnë e bien, poezi, Rilindja, 1975
2. Kanjushë e verdhë, poezi, Rilindja, 1978
3. Shenjat e shenjta, poezi, Flaka e vëllazërimit, 1979
4. Rrotull, roman, Naim Frashëri, 1983
5. Procesi, dramë, Zëri i Kosovës, 1984

Botimi i tërësishëm i këtyre veprave në një vëllim i jep mundësinë lexuesit që të njoh figurën e tij letrare padyshim të veçantë në *letërsinë shqipe të kohës*, në Kosovë e përgjithësisht.⁶¹

Zejnullah Rrahmani

Zejnullah Rrahmani, profesor, akademik lindi më 1952 në fshatin Ballovc të Podujevës, Kosovë, është shkrimtar shqiptar.

⁶⁰ https://sq.wikipedia.org/wiki/Jusuf_G%C3%ABrvalla (qasja e fundit me 24.01.2019).

⁶¹ Hamiti Sabri, "*Letërsia bashkëkohore*", Vepra letrare 9, Prishtinë, 2002, f. 352.

Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në Podujevë. Ka studiuar dhe është diplomuar në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Studimet pasuniversitare i mbaroi në Degën e Letërsisë Shqipe dhe magjistroi më 1984. Më 1985 mbrojti tezën e doktoratës në Fakultetin e Filologjisë të Prishtinës. Një kohë të shkurtër 1972-s punoi si mësimmhënës në gjimnazin e Podujevës. Rreth katër vite ka punuar në Ndërmarrjen Rilindja, në revistën Fjala. Më 1977 është zgjedhur asistent në Fakultetin e Filologjisë, ku prej atëherë është avancuar në titullin ligjërues, docent (1985), profesor inordinar (1990) dhe profesor ordinar (1995) . Edhe tash ligjeron lëndën Teori e letërsisë, në Fakultetin e Filologjisë. Prej vitit 1992 është profesor i studimeve pasuniversitare, ku ligjeron lëndën Teoritë letrare. Këto studime i ka reformuar e udhëhequr nga viti 1992–1998 në cilësinë e Kryetarit të Kolegjit të studimeve. Nga viti 1992 deri më 1996 ka qenë dekan i Fakultetit të Filologjisë. Anëtar i Kolegjit të dekanëve të Universitetit të Prishtinës ishte në periudhën 1992- 1996. Më 1995 është zgjedhur drejtor i Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Nga viti 1970 është anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Është anëtar i PEN Qendrës Shqiptare. Nga viti 1992 ka qenë anëtar i Këshillit Nacional të Shqipërisë për programet e letërsisë. Nga viti 1996 deri më 1999 e ka udhëhequr arsimin e Kosovës në cilësinë e Këshilltarit për arsim i kryetarit të Kosovës Ibrahim Rugova. Nga viti 1999 ka qëndruar disa herë në Kanada, përvojën arsimore–universitare të së cilës e njeh. Në dhjetor të vitit 2012 zgjidhet anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Në dhjetor të vitit 2016 zgjidhet anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.⁶²

Zejnullah Rrahmani si krijues letrar dhe si krijues, karakterizohet edhe me një dije e kulturë të madhe letrare. Kërkimet e tij në fushë të teorisë së letërsisë, duke pasur parasysh letërsinë e modernitetit shqiptar si dhe letërsitë moderne evropiane, kanë krijuar modelin e krijuesit me një vetëdije jo vetëm për teknikat moderne të shkrimit, po me shpërndërrimet moderne letrar që konstatojnë tejkalimin e konvencave.

Lirizimi personal në prozë dhe kërkimi simbolizues e përgjithësues janë dy karakteristikat themelore të të gjitha veprave të këtij autori që e bëjnë krejt të veçantë në *letërsinë bashkëkohore*, veçanërisht në gjininë e prozës, duke e ngritur në nivelin më të lartë të shkrimit letrar shqip sot.

⁶² https://sq.wikipedia.org/wiki/Zejnullah_Rrahmani (qasja e fundit me 17.11.2018).

Vepra letrare:

- Zanolet e humbura, roman, 1974, 1979
- Udhëtimi i një pikë uji, novelë, 1976
- Sheshi i unazës, roman, Prishtinë, 1978, Tiranë 1982, Prishtinë 1985
- E bukura e dheut, roman, 1987
- Udhëtimi arbdhetar, roman, 1992
- Mjeshtri i vetmisë, tregime, 1995
- Jusufi, roman, 1999
- Romani për Kosovën, roman, 1999
- 99 Rruzaret prej smaragdi, roman 2006⁶³

Agim Vinca

Është poet dhe studiues i njohur *bashkëkohor*. Lindi në Vleshtë të Strugës (1947), ndërsa jeton dhe punon në Prishtinë. Poezitë e tij janë të mbrujtura me dashuri dhe mallin për vendlindjen dhe luftën për ekzistencë të shqiptarit.

Disa nga vëllimet e tij më të njohura janë: “Feniksi”, “Buzëdrinas”, “Arna dhe ëndrra”, “Kohë e keqe për lirikën” etj.⁶⁴

Azem Shkreli

Lindi në Rugovë të Pejës (1938-1997). është njëri nga poetët më të njohur *bashkëkohorë shqiptarë*. Lirikat e tij kanë një gjuhë shumë të ndjeshme dhe shprehëse. Disa nga vëllimet e tij më të njohura janë: E di një fjalë prej guri, Lirikë me shi, Zogj dhe gurë etj.⁶⁵

⁶³ Hamiti Sabri, “*Letërsia bashkëkohore*”, Vepra letrare 9, Prishtinë, 2002, f. 448.

⁶⁴ Isak Shema, “*Kultura letrare bashkëkohore*”, Prishtinë, 2015, f. 78.

⁶⁵ Hamiti Sabri, “*Letërsia bashkëkohore*”, Vepra letrare 9, Prishtinë, 2002, f. 244.

Ramiz Kelmendi

Është nga shkrimtarët e njohur bashkëkohor shqiptar. Lindi në Pejë dhe jeton në Prishtinë. Në tregimet dhe romanet e tij ai trajton temat e zakoneve dhe të traditave shqiptare, fatin e shqiptarit, qëndresën e tij, etj.

Veprat e tij më të njohura janë: “*Heshtja e armëve*”, “*Ahmet Koshutani*”, “*Shtatë persona ndjekin autorin*” etj.⁶⁶

Sabri Hamiti

Lindi në Dumnicë të Podujevës. Është poet e prozator, dramaturg dhe një nga studiuesit më seriozë të letërsisë shqiptare. Është anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Veprat e tij më të rëndësishme janë: (poezi) *Njeriu vdes i ri*, *Trundu ilir*, *Melankolia*, (studime e kritikë) *Vetëdija letrare*, *Faik Konica jam unë*, *Letërsia moderne shqiptare*, *Lasgushi njëqindvjeçar* etj.⁶⁷

⁶⁶ Sabri Hamiti, “*Letërsia bashkëkohore*”, Vepra letrare 10, Prishtinë, 2002, f. 185.

⁶⁷ Isak Shema, “*Kultura letrare bashkëkohore*”, Prishtinë, 2015, f. 78.

KAPITULLI III

3. Historia e letërsisë shqiptare dhe disa probleme me tekstet shkollore

Historia e letërsisë merret me studimin e veprës letrare në rrjedhën e tyre historike. Ajo synon përfshirjen sistemore të fenomenit të letërsisë në kohë, të përshkruajë dhe të vlerësojë veprat e caktuara nga aspekti duke pasur parasysh zhvillimin e përgjithshëm letrar dhe kulturor, të mbledh përvoja dhe njohuri lidhur me periudhat e letërsisë dhe rrjedhat e caktuara të zhvillimit brenda distancave më të vogla ose më të mëdha kohore.⁶⁸

Edhe pas viteve '90 shkollat tona nuk u mbyllën, shkencat shoqërore si letërsia, filozofia, letërsia, sociologjia etj, vazhduan të mësohen. Mësuesit dhe pedagogët e universiteteve së pari i pastruan tekstet e tyre nga politizimet flagrante. Koncepte të reja, autorë që më parë ishin të ndaluar e të anatemuar, letërsia botërore e shekullit XX, pothuaj e gjitha e mohuar, tashmë zunë vend në programe e në ligjërata. Ashtu si heqjet e autorëve na programet ishin bërë për arsye politike, edhe vlerësimet e para për autorë dhe vepra të këtij lloji qenë më shumë të ngjyrosura politikisht, por tashmë në krahun tjetër. Ngjyrosjet politike në krahun tjetër e stigmatizoi një shaka që në ato vite qarkulloi në Tiranë: po kalojmë nga realizmi socialist, në realizmin demokratik. Kjo ndodhte se njerëzit që po bënë ndryshimet ishin po ata dhe se ishte përsëri po orientimi politik ai që po ndikonte më shumë për ndryshimet.

Tekstet e letërsisë botërore pothuaj sa u sollën në gjendje të pranueshme më parë sesa tekstet e programeve të tjera letrare. Me kohë dhe teoria e letërsisë dhe poetika e veprës letrare u vunë për fije. Kanë qenë ngutshëm të nevojshëm tekstet shkollore mbi letërsinë e vjetër shqipe (letërsia filobiblike, sipas Sabri Hamitit) dhe ato mbi letërsinë e quajtur të pavarësisë. Këtu tekstet e Sabri Hamitit mbi këto periudha kanë plotësuar boshllëkun e ndjeshëm. Pas vërejtjeve madje edhe anatemimve të fillimeve tekstet e Dhimitër Shuteriqit dhe të Rexhep Qosjes mbi historinë e letërsisë shqipe të Romantizmit mbeten deri më sot tekstet më të referueshme nga pedagogët dhe studentët Ajo që ende përbën problem është letërsia shqipe e gjysmës së dytë të shekullit të 20-të. Kjo letërsi që në programet tona shkollore dhe universitare merr një vend të konsiderueshëm, mbetet ende e papërfaqësuar nga ndonjë tekst që mund të merret shkencërisht në konsideratë. E megjithatë letërsia shqipe e shekullit të

⁶⁸ Milivoj Solar, "Teoria e letërsisë". Përktheu Ali Aliu, Prishtinë, 1978, f. 29.

njëzet vazhdon të jepet nëpër universitetet tona. Titullarët e kësaj discipline edhe tani pas njëzet vjetësh nga ndryshimet politike, nuk kanë guxuar që t'i bëjnë publike ligjëratat e tyre.⁶⁹

Sa për antologjitë, duhet përmendur përpjekjet e Ali Aliut, të Gjergj Zhejit, të Bashkim Kuçukut, të Ali Podrimjes e të tjerëve. Nëse profesorët nuk i botojnë ciklet e ligjëratave, nëse ato nuk i bëjnë pronë të publikut dhe të vështirimit kritik, kjo sigurisht ka të bëjë me pasigurinë e autorëve të tyre dhe kjo mbase-mbase do të thotë se ende nuk jemi të gatshëm edhe tani pas 20 vjetësh për hartimin e një historie të letërsisë. Ky mund të jetë një mendim kategorik, por tani për tani këtij fakti, kësaj vonese njëzetvjeçare nuk mund t'i gjejmë ndonjë justifikim tjetër me të cilin mund t'i shmangemi. Prapë e di mirë që kemi studiues të aftë dhe shumë të aftë – veprat studimore të viteve të fundit të Sabri Hamitit si dhe ato të Ali Aliut e të Ali Xhikut janë në udhën e një projekti në plotësimin e sipër për një histori integrale të letërsisë shqipe.⁷⁰

Ndryshimi i vazhdueshëm i synimeve artistike ndër brezat e shkrimtarëve nuk çon domosdoshmërisht në progresin e vazhdueshëm të vlerave, por historia e letërsisë është histori e synimeve të ndryshme artistike të realizuara në veprat e shkrimtarëve. Edhe brenda brezave të shkrimtarëve të realizmit socialist në Shqipëri, pati kërkesa për ndryshim e kjo solli ato arritje që u vunë re pas viteve gjashtëdhjetë. Liria brenda rregullave çoi individualitetet si në poezinë e Fatos Arapit, në romanet e Jakov Xoxës, veçanërisht romani "*Lumi i vdekur*", i cili pavarësisht nga idetë marksisiste që e përshkojnë, është një monument i vërtetë gjuhe dhe stili, sjell pasuri mjedisesh e karakteresh që nuk i ka hasur më parë letërsia shqipe. Po kjo liri brenda rregullit solli romanet e Sabri Godës, të Ismail Kadaresë, të Petro Markos etj.⁷¹

Synimi im kryesor ka qenë të vë theksin mbi nevojën e domosdoshme të një historie të letërsisë shqiptare, nevojë që ndihet më shume se kudo, në mësimin e letërsisë në shkolla.

Letërsia e sotme shqipe apo bashkëkohore filloi në vitet '50. Ajo karakterizohet me të veçantat e saj, njëjtë sikurse letërsitë pararendëse.

⁶⁹ "*Historia e letërsisë shqipe*", materialet e Konferencës shkencore 30-31 tetor 2009, në Prishtinë. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2010. f.f. 219-220.

⁷⁰ "*Historia e letërsisë shqipe*", materialet e Konferencës shkencore 30-31 tetor 2009, në Prishtinë. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2010. f. 220.

⁷¹ "*Historia e letërsisë shqipe*", materialet e Konferencës shkencore 30-31 tetor 2009, në Prishtinë. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2010. f. 223.

Ky punim del të jetë me shumë rëndësi ngase shpalos se sa u ofrohet nxënësve njohuri nga letërsia në tekste shkollore, por ne do të fokusohemi më shumë tek autorët e letërsisë së sotme shqipe.

Në kapitullin në vijim shohim se a është e nevojshme që të rishikohen tekstet shkollore, siç e kemi cekur edhe në hyrje të punimit se qëllimi i këtij punimi është të shpaloset përfaqësimi i autorëve të letërsisë së sotme shqipe në tekstet shkollore VI-IX.

KAPITULLI IV

3. Shpalosja e programit të leximit letrar VI-IX

LEXIMI LETRAR VI

Ky lexim dëshmon për përpjekjet dhe përvojën e autorëve, të cilët mbështeten në parimet bazë të tekstologjisë së sotme bashkëkohore. Nxënësit në këtë lexim njihen me gjini të ndryshme: proza (tregimi, romani), poezia (poezia epike, lirike). Gjithashtu mësohen e përsëriten figura të ndryshme letrare si: epiteti, krahasimi, hiperbola, etj. Nga ana tjetër, rubrikat mësimore e ndihmojnë mësimdhënësin që të realizojë një mësim aktiv, si dhe të zhvillojnë te nxënësi aftësinë në të folur, në të shkruar dhe në të lexuar (individualisht dhe në grup).

Në vijim shohim se cilët autorë të letërsisë së sotme shqipe janë përfshirë në leximin letrar VI dhe me cilat vepra janë përfaqësuar këto autorë.

Naum Prifti

Nga ky autor në leximin letrar VI është marrë një pjesë nga libri “Tregime të zgjedhura”, të këtij shkrimtari për fëmijë. Në këtë tregim flitet për atmosferën që zotëronte në qytetin e Korçës pas fitores së luftës kundër nazizmit.

Pjesa e marrë nga libri “Tregime të zgjedhura” quhet “Mandolina”.

Tema: Çdo pjesë letrare tregon diçka nga jeta. Në pjesën “Mandolina” shkrimtari tregon për ngjarje nga jeta e dy të rinjve, të cilët kishin shkuar të argëtoheshin në qytet dhe u lumturuan, kur me kursimet e tyre, blenë një mandolinë. Pra, shkrimtari nga jeta e këtyre djemve veçon një ngjarje: Çfarë iu ndodhi shokëve në Korçë, kur kishin shkuar të pushonin. Kjo është tema e pjesës. Shpesh titulli i pjesës shpreh shumë shkurt temën e saj.

Ideja e veprës letrare: Në çdo pjesë letrare (vjershë, tregim etj.) autori ka kurdoherë diçka të vlefshme për të na kumtuar. Kjo porosi e tij nuk jepet drejtpërdrejt, sepse do të dukej si një

pjesë letrare, por si shkrim këshillues, moralizues. Porosia e shkrimtarit është e fshehur brenda në shkrimin e tij dhe vjen te ne tërthorazi duke ndikuar në ndjenjat dhe emocionet tona. Pikërisht këtë ne e quajmë dhe *ide* të një vepre letrare.

Nasi Lera

Nga ky autor në leximin letrar VI është marrë tregimi “Djali dhe deti”, ky tregim është marrë nga libri “Vepra të zgjedhura” të shkrimtarit Nasi Lera. Autori rrëfen në mënyrë të figurshme përballjen e parë të një djali me valët e jetës. Djali ndien se nuk është më fëmijë, por i rritur.

Nasi Lera është shkrimtar bashkëkohor shqiptar, njihet si prozator.

Tema: Në tregimin “Djali dhe deti”, mund të themi se tema është mënyra se si e përballon jetën djali, që e shpreh përmes kuptimit të figurshëm.

Simboli: Në këtë tregim, deti, përveç kuptimit të parë merr edhe një kuptim tjetër të figurshëm. Fjalën deti ne mund ta zëvendësojmë me fjalën jetë. Jeta është si një det, herë e qetë dhe herë me dallgë. Ka raste kur ajo përballohet lehtë, por ndodh që të përballohet edhe me vështirësi. Djali është në një moshë të tillë, kur i shfaqet dëshira të ndiejë se është i zoti ta përballojë me krahët e vet jetën. Pra, ai mund të quhet tashmë i rritur. Kuptimi i dytë që merr fjala det, në letërsi quhet simbol.

Teodor Laço

Në leximin letrar nga ky autor paraqitet tregimi “Ushtar i lumtur”, ky tregim është shkëputur nga “Vepra të zgjedhura” të tregimtarit Teodor Laço. Në këtë tregim flitet se si një ushtar i thjeshtë rrezikon jetën për të shpëtuar një djalë. Kjo tregon se ai nuk e ndan betimin që ka bërë kur ka veshur rrobën ushtarake, me veprimin që i ndodh.

Tema: Te tregimi “Ushtari i lumtur” temë kryesore është *betimi* i ushtarit.

Teodor Laço është autor i shumë romaneve, novelave, përmbledhjeve me tregime, dramave, komedive, skenarëve të filmave artistikë dhe dokumentarë

Ismail Kadare

“Poezia e parë”, kjo pjesë është marrë nga tregimi “Poezia e parë” e shkrimtarit Ismail Kadare, i cili përmes kësaj poezie kujton me humor kohën e fëmijërisë, kur i ka lindur dëshira e parë për të shkruar. Gjithashtu Ismail Kadare në këtë lexim letrar përmendet edhe një herë tjetër, “Ra si yll, po s’u shua” janë vargjet e marra nga poema “Princesha Argjiro”, ngjarjet e së cilës lidhen me qëndresën shqiptare kundër Perandorisë Osmane.

Sabri Hamiti

Nga ky autor, në leximin letrar VI përfshihet poezia “Detyrat e shtëpisë” dhe përmes kësaj poezia poeti jep këtë mesazh – “*Për të mësuar nuk është kurrë vonë*”.

Dritëro Agolli

Në leximin letrar VI nga personaliteti i shquar i letërsisë shqiptare është shpërfaqur vjersha “Pylli qan për sorkadhen”, e cila vjershë është marrë nga libri “Pelegri i vonuar” i poetit Dritëro Agolli, i cili shquhet për ndjeshmërinë e lartë dhe fjalën e drejtpërdrejtë poetike. Në këtë vjershë, në të vërtetë, poeti qan për sorkadhen, por për ta dhënë dhembjen e tij në shkallën më të lartë, ia vesh atë sendeve.

Tema: Trishtimi

Nazmi Rrahmani

“Rruga për në qytet”, kjo pjesë është marrë nga romani “Tokë e përgjakur” e shkrimtarit Nazmi Rrahmani, i cili hedh idenë se një nga shkaqet e varfërisë është dhe padituria,

Azem Shkreli

“Katër këshilla vetes”, përmes kësaj poezie poeti jep disa këshilla poetike që lidhen jo vetëm me poetin por edhe me çdo njeri, i cili duhet ta jetojë jetën me pasion dhe kurajo. Më poshtë po i përcjellim vargjet e kësaj poezie:

*Mos u bëj poet nëse s'mund të lindësh
Me secilin varg, të lindësh me secilën fjalë.*

*Ngrehu mbi veten në do t'rrokësh frerët e erërave,
Të shkelësh shpërgajt e mërisë dhe shtrëngatat e gjakut tënd.*

*Nëse dashurohesh, dashurohu n'flakë e n'valë,
Jo në sy të kaltër, se bëhesh det i çmendur pendimi.*

*Mos u bëj poet nëse s'mund të vdesësh
Për secilin varg, të vdesësh për secilën fjalë.*

Ali Podrimja

“Me jetue”, këtë poezi poeti i madh kosovar Ali Podrimja ia kushton birit të tij Lumit. Poezia është shkruar në çastin kur Lumi vuante nga një sëmundje e pashërueshme.

Me jetue

*Erdhe në jetë
Nuk ka më nevojë për kuje lutje
Kryesorja të jetosh
Këtë gur ta hedhësh më lart se Unë
Prandaj
Sa më pak shikoje veten në pasqyrë
Dhe kurrë mos mendo: I pari
Ai që ka ekzistuar para teje jam Unë
Ai që do të kujdeset për ditët e mia të mbrama
Për ëndrrat e mia e qetësinë je Ti
Me pleh kurrë mos u pajto: Nxirre në gjysmë të natës
në pikë të vapës.
Asgjë mos rrit, asgjë mos krijë me dhunë
Rast i humbur nuk je edhe pse pylli
Dendësohet
Mund ta kalosh natën në Kullën time të vetmuar*

*Në botë
Dhe si të duash Ti Lumi
Kryesorja: Jetën ta jetosh pa e vrarë
Dhe pa të mbetur në këmbë ndonjë therrë
E saj e zezë
Bashkëudhëtari im
Ta provojmë vetveten derisa kemi frymë.*

Vëllimi poetik “Lum Lumi”, i cili lindi nga fatkeqësia e autorit (vdekja e të birit) është ndër veprat poetike më të bukura në mbarë poezinë shqipe. Duke qenë homazh për të birin, ky vëllim njëherësh shpreh edhe preokupimin ekzistencial të autorit, dilemën, vetminë, frikën, vdekjen dhe përgjithësisht fatin e njeriut dhe të kolektivitetit tonë kombëtar.

Agim Vinca

“Buzëdrinas”, në këtë poezi, poeti Agim Vinca bën një portret të bashkëvendësit të tij, si dhe një autoportret të vetvetes si poet duke u nisur nga cilësia e përbashkët e të jetuarit buzë lumit Drin.

Ramiz Kelmendi

Sa i përket këtij autori, në leximin letrat shpërfaqet pjesa “Në veri”, kjo pjesë tregon për përshtypjen e autorit nga udhëtimi në Norvegji.

*E vetmja “shenjë” e kalimit të kufirit suedezo-norvegjez ishte natyra e thjeshtë gjeografike.
Aty, me të shkelur në Norvegji, niste një konfiguracion i ri tokësor. I lamë vërrijet suedeze
dhe hymë nëpër pyje, male, tunele, kodra, bjeshkë...*

Ky lloj i shkrimit quhet reportazh; ai i pasqyron njerëzit, ngjarjet dhe dukuritë në çastin kur shihen. Dallon shumë nga romani, novela etj., sepse këtu ngjarja paraqitet me shumë saktësi dhe përshkrimet janë reale. Nuk ka trillime, pavarësisht se autori i shkruan ato nga këndvështrimi i tij.

Në leximin letrar janë përfshirë edhe autorët **Qamil Batalli** (Dy Teutat), **Ymer Elshani** (Plaku me violinë), **Ilirian Zhupa** (Atdheu), **Vehbi Kikaj** (Dy shitëset e luleve), **Ibrahim Kadriu** (Libri për princin e lumtur), **Gjergj Zheji** (Gjergj Zheji), **Faik Ballanca** (Njerka), **Adem Gajtani** (Bota fëmijërore). Këto autorë janë ndër shkrimtarët tanë më të shquar të letërsisë për fëmijë, ndonëse shkruajnë edhe për të rritur.

Në leximin letrar VI janë përfshirë gjithsej 46 autorë, jo vetëm shqiptarë por edhe të huaj. Ndërsa sa i përket letërsisë së sotme shqipe, në leximin letrar VI i hasim 21 (45%) autorë.

LEXIMI LETRAR VII

Në këtë lexim letrar nxënësit njihen me gjini të ndryshme, ndër më të theksuarat janë proza, poezia, romani, drama etj. Gjithashtu mësohen e përsëriten figura të ndryshme letrare si: epiteti, krahasimi, hiperbola, etj.

Ismail Kadare

Në leximin letrar VII, autori i parë bashkëkohor që e hasim është Ismail Kadare, me tekstin “Shënime nga Kapiteneria e Portit”.

Ngjarja në tekstin “Shënime nga Kapiteneria e Portit” u zhvillua kur shqiptarët shkonin refugjatë në Itali.

Në këtë tekst autori nuk shprehet drejtpërdrejt, por përmes personazheve. Pra, ka raste të shprehjes kur nuk është autori ai që shprehet drejtpërdrejt, por janë personazhet e veprave artistike që ndërmjetësojnë në mes të autorit dhe lexuesit. Një rast të tillë e kemi në këtë tekst.

Tema: Lënia e atdheut dhe vendosja e shqiptarëve në Itali.

Faik Ballanca

Nga ky autor bashkëkohor, në leximin letrar VII e kemi këtë tekst “Kënga e fundit e Marko Boçarit”. Pra, “Kënga e fundit e Marko Boçarit” është fragment i shkëputur nga novela me të njëjtin titull.

Marko Boçari (heroi shqiptar që luftoi për çlirimin e Greqisë) 1790-1883, luftëtar suliot i kohës së Ali Pashë Tepelenës. Luftoi me armë në dorë për çlirimin e Greqisë. Mori pjesë në kryengritjen e popullit grek kundër robërisë osmane dhe u vra në Karpenis.

Tema: Lufta për çlirim

Në këtë fragment autori vajton veten se po vdes, gjithashtu shpreh edhe zhgënjimin e tij se po vdes për atdhe të huaj. Por, në fund ai thotë: “po vdes, po mos mbani zi”. Ai dëshiron që ta varrosin pranë fortifikatës Gjergj Kastrioti, kjo për arsye që hija ta qetësojë atë.

Kënga e fundit e Marko Boçarit

Armët i kam pranë, po s'luftoj dot. Kitarën e kam pranë, por s'këndoj dot. Po vdes. . . Këmba ime nuk do të shkel më kurr mbi shkrepat e Sulit. Meteorët e përgjakur s'patën vend për këtë lëngë të sertë që më rrjedh nga plagët dhe që është jeta ime. Se gjaku i kombit tim është shprishur e rrjedh nëpër Ballkan e nëpër Evropë, kudo që ngre krye lira.

Ne jemi gladiatorë, që e shpërthyem arenën
Karpenisi! Mbi kokën time djeg dielli i huaj i Eladës.

I verdhë si limon ky qiell. Mbi buzën time po rreshkën kripërat e fundit. S'kam një bulë ujë dhe zemra po më çahet nga amlli. Nuk mundem të këndoj. Fytyra e Krizesë dhe tim biri buzëqeshin përtej pyllit të gjelbër me ullinjë.

Ku jeni? Era gënjeshtare lot me mua dhe shpërndan mall e këngë të vjetra lufte, si atëherë kur ndotheshim tek Pesë Pusët, në Qafë, apo në kështjellën e Shën Venerandës.

Ku vemi? Ky vig që lëkundet më kujton djepin e nënës, që më merrte gjithmonë në shpinë. Me djepin tim e të Konstandinit im 'ë u çonte barut luftëtarëve. Nga gjumi më zgjoi një krismë, dhe një krismë po më vë në gjumë.

Më ngadal, ju shok që më bartni! S'më shpini dot në Seleidë. Eshtrat e mia do t'i presë një tokë tjetër. Po vij, Mesolongj. Është mesditë. Stërkat e dallgëve vrapojnë mbi krahët e baticës dhe rrethojnë tërë brigjet e tua me shkumë të bardhë, që mërmërit se unë po vdes. Vërtet po vdes, po mos mbani zi. Se unë nuk jam më trim i kombit tim. Në atë arenë të vogël të huaj kanë ngjallur përçarjen e llahtarshme: vëllavrasjen. Vetëm kjo na ka prishur. Unë jam një gladiatorë, që e gjeta rastësisht derën e hapur. Dhe u përpoqa që të mbroj këtu lirinë që gëzoja në malet e mia, në sajë të armëve që kam në trup. Gjaku im vritet akoma. Kush e di

*për sa kohë? Kush e di se kur liria do të trokas mbi atë dhe të zhuritur pëllëmbë
gjak, siç po troket tani në Eladë. Shpejt. Shumë shpejt.
. . . Më dhemb diçka. Diçka s'e krevë . . .
Po mbërrijmë. Hapuni porta, paçka se çepallat e mia po mbyllen dhe shokët nuk i
shquaj dot! Më varrosni pranë fortifikatës Gjergj Kastioti, që hija e tij të më
qetësojë . . .*

Dritëro Agolli

Dritëro Agolli shkroi poezi, poema, tregime, novela, romane, drama, skenar filmash etj. Në këtë lexim ky autor përfaqësohet me vjershën “Nusja nga Kosova”.

Autorit i shfaqet dëshira që nipi i tij të ketë një nuse nga Kosova, por diçka e pengon këtë dëshirë. Këtë dëshirë, që nipi i tij të marrë nuse me kuaj e ndalonte kufiri me dy pasaporta.

Teki Dervishi

“Lëngata e poetit” është teksti i Teki Dervishit në leximin letrar VII.

Vepra “Zhvarrimi i Pjetër Bogdanit” e ndërton krijuesin si hero kulturor, tani të gjetur në trashëgiminë e kulturës shqiptare. Pra, ky autor është i njohur për vepra dramatike, ndërtimet dramatike të këtij autori ngjiten në trashëgiminë e tij letrare në poezi e në prozë, duke ruajtur në mënyrë të habitshme edhe lirizmin dhe rrëfimin.

Anton Pashku

Anton Pashku, shkrimtar i njohur i letërsisë shqipe, shquhet për mënyrën e veçantë të shkrimit të tregimit. Në kohën kur e kishte shkruar tregimin “Klithma”, pra që paraqitet në leximin letrar, kishe pak lexues që e kuptuan gjuhën e tregimit të tij. Madje, edhe e mohuan. Ishin vitet e pesëdhjeta të shekullit të kaluar. Në Kosovë ushtrohej terror ndaj popullsisë shqiptare nga policia serbe. Pretekst ishte mbledhja e armëve, kurse qëllimi ishte të bëhej presion për shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi. Dhe, mu në atë kohë, në atë moshë, shkrimtari e shkroi këtë tregim.

Në tregimin “Klithma” autori flet për ngjarjet në Kosovë, pra, për aksionin tragjik për shqiptarët. Aksioni i UDB-së, pra, mbledhja e armëve, që ishte një terror shumë i egër dhe ky terror u pasua me shumë shqiptarë të shpërngulur, pa dëshirën e tyre ose mirë të themi me dhunë drejt Andollit të Turqisë.

Mund të themi se krimi duke u artikuluar si shqetësim i autorit, ka mbetur si një dëshmi e fuqishme e kësaj tragjedie. Krimi që u ushtrua në Kosovë, Anton Pashku e ka sigmatizuar në shkallë universale, siç ndodh në artin e madh.

Tregimet e para të Anton Pashkut nuk i sjellin ndonjë të re letërsisë shqipe sa i përket trajtimit të ngjarjeve dhe nuk i sjellin pikërisht pse në to nuk bëhet fjalë për ngjarje lufte, por në radhë të parë për pasojat e saj në botën shpirtërore të njeriut

Tema: Dhuna mbi individin. Pra, në këtë tregim të shkurtër hetohet atmosfera e rëndë nga dhuna që u ushtrua mbi popullsinë shqiptare në vitet kur edhe u shkrua tregimi.

Yllka Domi

Yllka Domi u vra më 7 maj 1999, në sythin e pranverës. Gjaku i saj i njomë ra si vesë mbi lulëkuqet rrëzë Çabratit, të cilat tash, sa herë lulëzojnë, janë më të kuqe dhe me aromë lirie.

Janë shumë të pakët emrat që kanë lënë gjurmë në shkrimin letrar pa i mbushur 18 vjet. Yllka edhe me këto pak poezi që i ka shpëtuar dëshmon se kishte talent.

Në këtë lexim Yllka Domi përfaqësohet me poezinë “Ti fluturon me dallëndyshet”. Kujt i këndonte Yllka? I këndonte pranverës, dallëndysheve, këngës së bilbilit, më të dashurve të vet, i këndonte dashurisë, rinisë, lirisë, i këndonte jetës dhe vdekjes.

Eqrem Basha

Poezia e Eqrem Bashës kushtuar dëshmorit të panjohur është një nga poezitë e paraqitura në këtë lexim letrar.

Tema: Te poezia “Te varri i dëshmorit të panjohur” temë kryesore është liria.

Arif Demolli

Arif Demolli në leximin letrar VII përfaqësohet me veprën “Vdekja e Akanit”.

Proza e Arif Demolli i ka dy shtrirje tematike dhe stilistike të karakterizuara.

- Në të parën hyjnë veprat subjektive, ku burimi i temave dhe amë e shkrimit është vetja, fëmijëria: ku shkrimi merr shenja të elegjisë me një ngjyrim të humorit, dhe ku shkruesi është i mbështjellë me një vel të pësimit. Këtu hyjnë veprat: Pëllumbat e kujtimeve, Lushi si askushi, Të gjallët dhe të vdekurit e një fëmijërie.
- Në shtrirjen e dytë hyjnë veprat autoriale, ku gurrë e tematikës është realiteti, kurse ama e shkrimit letrar mbështetet në humor të zi, utopi, hiperbolë, dhe karikaturë dhe kur veprimi i autorit në trajtën e gjykimit, veprës i jep një status përjashtues e satirik. Këtu hyn edhe kjo vepër, pra, “Vdekja e Akanit”, por edhe disa vepra të tjera: Ballkanet e një qyteze dhe Si mbetën gjallë shqiptarët?

Ali Podrimja

Në leximin letrar të klasës VII, e hasim shkrimtarin bashkëkohor Ali Podrimja me poezinë “Vrima e parë e fyellit tim”.

Guri: Epika e Kozmetika

Një kërkesë e asgjë më shumë: me qëndrue, me qëndrue deri në fund, edhe kështu si jam (i plagosur)?! Me qëndrue duke u identifikuar figurativisht me gurin, sepse vargjet thonë dhe e shqiptojnë veten:

*dhe askujt s'i falem
as forcës sate*

Është kjo kërkesë për qëndruesë e identifikim me gurin, me forcën e tij, si kthim i vonuar në vete, në një qenësi ku nuk janë tharë ende damarët e fortë, pra edhe ikje nga bota e agresivitetit në një vetëpërmbyshje shpirtërore e vetëngushëllim:

*pesha jote më tërheq kah Toka-drejt peshimi
larg haleve-e-valëve-e-fjalëve
që kryet ma kërkojnë*

Kërkohet identifikimi me *gurin* duke iu rrëfyer kësaj figure poetike kaq të stabilizuar kuptimisht e poetikisht në poezinë e mëparshme të këtij autori, si një qerthulli për shpëtimin e kokës e të mendjes nga thashethënat dhe sytë e këqij e lakmitarë. Po durimi dhe shtrëngimi i paprashëm deri në tkurrje nuk është qëndresë. Këtë dilemë e shtron edhe vetë teksti poetik në vijim, që shtrohet si drojë, si shqiptim i mosbesimit: *prezenti im a do të jesh ti?* Të gjitha këto dalin si shqiptime të frikës nga *tkurrja*, e cila e mbyt lëngun e jetës dhe prish mundësinë e identifikimit me *gurin*, me frymën e qëndresës. Sepse vetë koha dhe rezultati i udhëtimeve të mbytura nga dëshira kërkimtare e humb dhe e lëkund besimin për:

*Çaste epike
në Erën e kozmetikës*

Dilema zgjeron kontekstin, për aq sa përafrohen në poezi dy botëra plot kontraste. Kështu edhe një herë merr zë kontrasti si figurë e parë poetike e poezisë si kritikë e jetës. Era e guri, e qëndresës së paluhatshme, era e epikës, përballë Erës së kozmetikës, të shkëlqimit të rrejshëm e mashtrues. Poeti kërkimtar i ngjyer nga përvoja e kërkimit të këmbëngulshëm të identitetit, kur vihet në dilemë mbi mundësinë e gjetjes së tij, hidhet edhe një herë në krijimin e figurës përmbyllëse të qëndresës së mëtejshme – *gurin*. Në këngën e dytë të kësaj balade, i kushtohet krijimit poetik të këtij identiteti, me çdo kusht, i pushtuar nga frika se do t'i humbet i tëri. Kjo këngë del variant i fjalë-figurave me bazën *gur*, që duan ta ruajnë apo ta krijojnë identitetin e figurës poetike në poezi, apo identitetin e sendit *gur* në jashtësi, për ta matur me të mundësinë e qëndresës:

*Ç'gurron guri në gurinë
gur guri ndër gurë më i guri*

*gur i gurëzuar pranë gurit
gruth i nguruar rreth gurit*

*gurron guri në gurë gurësh
guro guroje gurin në gurinë*

*ç'guri pranë gurit guri guri
birë e parë e fyellit tim*

E në fund, prapë një ndërhyrje e shkëputur e autorit, e cila manifestohet si dëshirë-konkludim. Pra edhe teksti i poezisë del më shumë vlerësues sesa shprehës. E teksti del i diferencuar shumë nga teksti tjetër paraprijës, del si konkludim mbi pamundësinë e prishjes së identitetit të figurës së tij të preferuar, *gurin*, dhe të fortësisë së qëndresës që shtrin si kuptim kjo figurë. Mirëpo, edhe ku vlerësim poetik vjen si vetëgushëllim i vonuar për poetin, sepse *Dilema* përball *qëndresës* vjen e bëhet edhe më e madhe sa edhe vetëdija mbi pamundësinë e gjetjes së identitetit e të individualitetit i cili vazhdon të shprishet duke u shqiptuar në vargjet:

*ruana zot
nëse guri na tradhton*

Dilemën e shton edhe më shumë hamendja mbi mundësinë e vënies së këtij guri në kullë, në këtë objekt-figurë-mit të qëndresës në poezinë e mëparshme të Ali Podrimjes.

Autorët e tjerë bashkëkohorë që janë përfshirë në leximin letrar të klasës së shtatë janë: **Bilal Xhaferi** (Baladë Çame), **Jusuf Buxhovi** (Qyteti i rrethuar), **Sabri Hamiti** (Vaji për Prishtinën), **Dino Buxati** (Kolombreja) dhe **Bardhyl Xhama** (Hidrocentrali gjigant).

Në leximin letrar VII janë përfshirë gjithsej 37 autorë, jo vetëm shqiptarë por edhe të huaj. Ndërsa sa i përket letërsisë së sotme shqipe, në leximin letrar VII i hasim 14 (37%) autorë.

LEXIMI LETRAR VIII

Ashtu si edhe në leximet letrare pararendëse, edhe në leximin letrar VIII nxënësit njihen me gjini të ndryshme, gjithashtu nxënësit mësohen e përsëriten figura të ndryshme letrare, vetëm që në këtë lexim bëhet në mënyrë më të thelluar se sa në leximet e klasës VI dhe VII.

Din Mehmeti

Me poezinë “Liria” Din Mehmeti e shpreh përjetimin e tij për lirinë. Kur autori e shkroi këtë poezi ishte viti 1999, atëherë kur edhe Kosova u çlirua.

Tema: Në poezitë e Din Mehmetit, *liria* pothuajse çdo herë ka qenë kryetema.

Liria

Është ëndërr drite

Flakë gjaku

Duhi shpirti

Sytë plot pranvera i ka

Plot shtigje zogjsh

Zjarr kënge është

Është dritare e hapur kah dielli

Bulëzim i ri

Kaltëri

Dhe rreze

Gjakovë, shtator 1999

Beqir Musliu

Muza poetike në poemën “Skënderbeu” të Beqir Musliut krijon faqen e re në poezinë shqipe të kohës si dhe artikulon madhështinë e kësaj epoke që ka ruajtur hijen e madhështinë e Skënderbeut. Në këtë vëllim poetik Beqir Musliu ka shkrirë shumë pika kulminante të ëndrrës, për ditët që i mungonin atdheut tonë. (Nexhat Rexha)⁷²

Janë të shumtë autorët që kanë shkruar për heroin tonë kombëtar e një nga këta është edhe Beqir Musliu , i cili i ka kushtuar një poemë me titullin: “Skënderbeu”. Beqir Musliu e ka ndërtuar imazhin heroik për Skëndebeun si hero kombëtar dhe si hero letrar deri në mitizim të plotë të figurës së tij historike. (Rovena Vata)⁷³

⁷² <https://2lonline.com/skenderbeu-ne-poezine-e-beqir-musliut/> (qasja e fundit më 15.02.2019)

⁷³ <https://2lonline.com/skenderbeu-i-mitizuar-ne-poemen-e-shkrimtarit-beqir-musliu/> (qasja e fundit më 15.02.2019)

Skënderbeu

*Gjuha u shkri ne diell si fjala në psherëtima
E gurit te forte ne dashuri emër i kish dhënë
Rrugës se shkruar me trëndafila e shkrepetima
Gjakun për ta ruajtur bashkë me shqipen Nënë*

*Kalanë mbi ëndërr e çelën vetëm ëndrrat e veta
Atëbotë kur shqiponjat sollën gëzim dhe drite
Se bashku me malësoret e kurorëzuar ndër shkrep
Te madhëruar me kohen e Arbrit mbetën historitë*

*Rrugës se lavdisë kush i doli mbanë aq krenar
I madh në dashuri dhe i patundur ne shpresë
O vetëm Shqipja që fërfëlloi flatrat në zjarr*

*Tash me të urtin Promete u zgjua ne histori
I bëri të lirë e të pastër të lidhur në besë
Tërë Ballkanin e madhëroi me Bijtë e tu Arbëri*

Mehmet Kraja

Në leximin letrar të klasës VIII, Mehmet Kraja përfaqësohet me veprën “Zhvarrimi”, prej kësaj vepre është paraqitur fragmenti me titulli “Zhvarrimi”.

Më 1478, Mehmeti i Dytë, sulltan i Perandorisë Osmane, urdhëroi që të hapet varri i Skënderbeut. Ushtarët turq nxorën nga varri eshtrat e Skënderbeut dhe pjesë e këtyre eshtrave i mbanin si hajmali për të forcuar guximin e tyre. Në këtë fakt historik janë mbështetur shumë shkrimtarë dhe secili në mënyrë të veçantë e ka shprehur në krijimet letrare, kështu bëri edhe Mehmet Kraja.

Jakov Xoxa

Nga Jakov Xoxa në këtë lexim e kemi fragmentin “Adili dhe Vita”, që është marrë nga romani i njohur “Lumi i vdekur”.

Liria brenda rregullave çoi individualitetet në romanet e Jakov Xoxës, veçanërisht romani “*Lumi i vdekur*”, i cili pavarësisht nga idetë markisiste që e përshkojnë, është një monument i vërtetë gjuhe dhe stili, sjell pasuri mjedisesh e karakteresh që nuk i ka hasur më parë letërsia shqipe.

Pra, ky fragment proze është marrë nga romani i njohur “Lumi i vdekur” i shkrimtarin shqiptar Jakov Xoxa. Ngjarja bën fjalë për dy të rinjë, Adilin, të shpërngulur me gjithë familjen nga Kosova, nga dhuna serve, dhe Vitën myzeqare, të shpërngulur me familje nga Myzeqeja.

Mihal Hanxhari

Ky autor bashkëkohor në leximin letrar VIII paraqitet me elegji, pra “Elegji për Kosovën”.

Elegji për Kosovën, më shumë se elegji, është një lutje që hapet e s’mbyllet assesi. Një kthim nga Qielli, kur Toka është e humbur. Një kthim nga Zoti, kur toka mbetet pa Zot. Elegji për Kosovën është dëshmia e madhe e dramës së Kosovës.

Kjo poezi që u botua një muaj pas vdekjes së Mihalit u vlerësua lart nga poeti kosovar Ali Podrimja si më e mira për tragjedinë Kosovare.

Qerim Ujkani

Nga ky autor në leximin letrar e kemi vjershën “Kthimi i ushtarit në shtëpi”. Në këtë poezi është evokuar e kaluara e popullit shqiptar përgjatë shekujve. Autori përmes poezisë e shprehte çdo preokupim për fatin e vendit të tij.

Në vjershën “Kthimi i ushtarit në shtëpi” ushtari është personifikim i luftëtarit të përjetshëm. I luftëtarit historik i nisur nga largësia me mall dhe dashuri ndaj njerëzve dhe atdheut. Ai është ushtari që personifikon qenien tonë që gjithmonë ka luftuar nëpër shekuj për të na liruar nga robëritë shekullore për një jetë të dinjitetshme. E ka preokupuar gjithmonë vendi,

Kosova, atdheu ynë”, ka shtuar Hoxha.

Kthimi i ushtarit në shtëpi

Po vjen nga lashtësia me mall në sy

Me diellin dhe hënën tok ecën ti

Si s'të lodhi rruga që s't'u nda

Shekuj ti kalove, kalove dhe epoka

Thonë se të panë n'një betejë

Me nishan në ballë përmbi të hodhën dhe

Sytë të mbeten hapur t'i mbuluan me shami

Shokët të kënduan dha jetën për liri

Anija është fundosur në det diku atje

Tok me barëra të qeta vetëm tash ti fle

Dhe rob ty të zunë pa shteg në rrethim

Prangat ke në duar larg atje në mëgrim

Tash në tredhe me ditë edhe me natë

Mbytur në vetmi bredh si refugjat

Avioni u rrezua tanku u dogj në flakë

Toga u shkatërrua plumb ke në gjak

Thonë e ç'nuk thonë në një port të panë

Pa dorë e pa këmbë vashat të qanë

Po ti ec e ec kah vatra atërore

Plot me mall në gji kujtime fitore

Po s'arrin që s'arrin dot në shtëpi

Udhëtar i përjetshëm në histori

Gjithmonë ushtar deri sa luftë të ketë

Në tokë e në ajër në lumë e në det

Kot të pret fisi miqt me shokë

Kalo pra ushtar dhe ndonjë epokë.

Agim Spahiu

Në poezinë “Këtu” kjo filozofi e jetës dhe e vdekjes, ku ndodhej dhe ku ndodhet poeti, shpallet ndoshta më bukur dhe më hapur se kudo në poezinë e tij dhe kudo në poezinë shqipe. Poeti kishte kultin e vendlindjes, kishte kultin e flijimit për vendlindjen, deri edhe për imtësitë më të thjeshta e më të rëndomta të vendlindjes.

Këtu

*Këtu dielli rrezon për mua dhe bora boron për mua,
në gjakun tim shkrirë janë të gjitha viset e tua,
rroj në male fisnike me ujëra jetëdhënëse në gji,
në përqaftimin e lumenjve të mi: njëri i Bardhë,
tjerti i Zi.*

*Këtu jam, gjithnjë, mbi Gjalicë e Pikëllimë,
i mbushur me kujtime,
këtu lëndohet e gazmohet zemra ime.*

Nuk mund të rroj ku s’kam ç’të kujtoj.

*Këtu jam i idhët pelin, i ëmbël si misri i ri,
këtu jam plot shëndet,
kam shumë punë për të bërë dhe s’kam ngë të vdes...*

*Këtu dhe vetëm këtu jam guri me rrënjë,
i rëndë në vend të vet,
çdokund tjetër rrumbullohem, troshitem e harrohem,
vetëm këtu thepohem...*

*Këtu jam zjarr që djeg, dorë e bardhë që përkëdhel,
fjalë mjaltë që mrekuqon, vuajtje që s’harron...*

*Brenda meje përkunden djepe, shtrihen varre pa harrim,
digjen e rilinden malet e visit tim.
“Këtu!”, më thonë djepet e varret, drurët e gurët,
“Këtu!”, Shekspiri është luajtur dhjetëfish,
ta dish,
në familje, buzë kufijsh
dhe brenda gjoksit të njeriut!
Jam këtu përqaftuar me diellin,
dragua për të mos harruar asgjënë,
mbrojtës, rojtar nderi i fytyrës sime që s’e çbënë...
Këtu me tokën përjetësisht jam i dashuruar,
si fëmijën e puth, e mbaj, e kthej me duar.
Rris pemët, shtrydh gurin e ujin të më japin më tepër
dhe unë gjithçka u jap: në çdo gjë pjesëtoj veten.
Me armiqtë thikë më thikë jam këtu, sy për sy,
i dashuruar me të dashurit e mi.
Këtu dhe vetëm këtu jam puthja, mallkimi, ëndrra
dhe zgjimi,
dashuri në udhët e tua, ku bora dhe dielli rrezojnë për mua...*

Rexhep Qosja

Drama është një nga gjinitë kryesore të letërsisë artistike. Veçori dalluese e dramës është se ndërtohet nëpërmjet dialogut dhe monologut.

Teksti i dramës mund të lexohet si çdo tekst tjetër, por ai është i shkruar për t’u shfaqur në skenë.

Rexhep Qosja në këtë lexim përfaqësohet me dramën “Beselam, pse po më flijojnë”. E shkruar në vitet '70, drama “Beselam, pse po më flijojnë” merret me mitin e sakrificës. Bazuar në legjendën e Rozafatit, drama “Beselam pse po më flijojnë” ndërton përpjekjen e saj për sakrificë.

Në një qytet imagjinar dhe të izoluar, sunduesi dhe partia e qytetit përpiqen t’i mbajnë nën kontroll qytetarët duke u premtuar atyre ndërtimin e një ure, duke u përpjekur t’i bindin ata që

të heqin dorë nga planet e tyre për ta ndërtuar atë.

Ashtu si në legjendën e Rozafës, ura që është ndërtuar gjatë ditës, bie natën.

Duke kujtuar mitin, profeti i bind zotërinjtë e qytetit që të sakrifikojnë një nga gratë e tyre, me qëllim që mallkimi të ndalet.

Por sakrifica ishte e kotë.

Autorët e tjerë bashkëkohorë që janë përfshirë në leximin letrar të klasës së tetë janë: **Kiço Blushi** (Më fol shqip), **Musa Ramadani** (Trofeu i gjallë), **Bilal Xhaferi** (Vdekja në udhët e Çamërisë), **Ismail Kadare** (Baladë Nizamësh), **Rifat Kukaj** (Kullat e errëta), **Skënder Drini** (Kur ta kemi flamurin në mjedis të Kosovës), **Zejnullah Rrahmani** (Ushtarët e huaj), **Sabri Hamiti** (Gjumi i diellit), **Eqrem Basha** (Baladë për njeriun që zgjohej me shpresë), **Nasi Lera** (Ne të dy).

Në leximin letrar VIII janë përfshirë gjithsej 44 autorë, jo vetëm shqiptarë por edhe të huaj. Ndërsa sa i përket letërsisë së sotme shqipe, në leximin letrar VIII i hasim 18 (40%) autorë.

LEXIMI LETRAR IX

Në këtë lexim letrar janë dhënë karakteristikat themelore të periudhave letrare dhe të shkrimtarëve përfaqësues. Për shkrimtarët janë ofruar shënime themelore bibliografike, në mënyrë që nxënësit të kenë një informacion të nevojshëm dhe të krijojnë një përfytyrim për jetën dhe veprën e tyre pa u ndalur në mënyrë të veçantë në këtë aspekt.

Letërsia bashkëkohore në këtë lexim është ndarë si një nënkapitull dhe bëhet një sqarim se si diferencohet ajo, prej cilit vit fillon kjo letërsi, çka zhvillohet në këtë letërsi. Gjithashtu në këtë libër, autorët bashkëkohorë ndahen në këtë mënyrë: *Autorët që e përparuan shprehjen poetike në letërsinë tonë të sotme janë: Martin Camaj, Esat Mekuli, Enver Gjerqeku, Fahredin Gunga, Ali Podrimja, Dritëro Agolli, Ismail Kadare, Din Mehmeti, Fatos Arapi, Rrahman Dedaj, Azem Shkreli, Sabri Hamiti, Eqrem Basha, Xhevahir Spahiu, Bardhyl Londo etj.; në prozë janë: Jakov Xoxa, Anton Pashku, Ismail Kadare, Kasëm Trebeshina, Fatos Kongoli, Zejnullah Rrahmani Mehmet Karaja etj.; në dramë shquhen autorët: Etëhem Haxhiademi, Anton Pashku, Kolë Jakova, Rexhep Qosja, Kasëm Trebeshina, Teki Dervishi,*

Ymer Shkreli etj. Në këtë periudhë u shënuan arritje të mëdha edhe në fushën e studimeve dhe të mendimit kritik për letërsinë, ku shquhen sidomos Dhimitër Shuteriqi, Rexhep Qosja, Ibrahim Rugova, Sabri Hamiti, Agim Vinca, Aurel Plasari, Kujtim M. Shala, Kujtim Rrahmani, Ag Apolloni e të tjerë. Por, ka edhe shumë autorë të tjerë që nuk janë përfshirë në këtë ndarje.

Të vetmit autorë që janë përfshirë në këtë lexim janë Ismail Kadare, Anton Pashku dhe Ali Podrimja.

Ismail Kadare

Në leximin letrar IX, në fillim flitet për jetën dhe veprën e Ismail Kadaresë dhe pastaj bëhej një analizë për romanin “Kështjella”.

Tema: Te romani “Kështjella” tema është e kaluara e popullit tonë, nga periudha e Skënderbeut.

Ali Podrimja

Edhe te ky autor kemi strukturën e njëjtë, në fillim jepet një pasqyrim për jetën e tij, pastaj edhe për poezitë e tij.

Nga ky autor në leximin letrar janë paraqitur dy poezi të tij, e ato janë “Një natë nga netët pa gjumë” dhe “Rozafati”. Pra, në vazhdim do ta analizojmë Rozafatin.

Rozafati

Secili i falëm nga diçka

kush emrin

kush eshtrat i la

nga gjaku

nga zjarri

koha saherë eksplodoi

*rreth diellit tonë
sytë shpella i bëmë
në bjeshkë s'pushuan tupanët*

*se secili i falem nga diçka
armikut ia shtruam rrugën
me kufoma
deri te zemrat tona*

*e ai kurrë s'e shkeli
perënditë tanë
kurrë s'mun i arriti*

*se secili i falem nga diçka
kush emrin
kush eshtrat i la*

Këtë poezi poeti ia kushton Kalasë së Shkodrës, njëres nga fortesat tona, e cila simbolizon qëndresën, vjetërsinë, autoktoninë, por edhe shpirtin liridashës dhe human të popullit tonë. Këtu kjo kala del më shumë se një objekt konkret, për të cilin populli ka krijuar legjendën e njohur. Ajo është fortesë të cilën populli e ngriti me sakrifica të shumta me flijime...

Armikut, thotë poeti, ia shtruam rrugën me kufoma deri te zemrat tona, të cilat ai kurrë nuk i arriti. Kjo kala është simbol i paprekshmërisë së territorit dhe të etnisë sonë, fortesë e ngritur me emrat dhe me eshtrat e njerëzve të këtij trualli.

Për fortesën poeti flet në vetën e tretë, bën një rrëfim të singertë, një monolog që vjen si një kuvendim sa me vetveten, po aq edhe me qenien kombëtare.

Anton Pashku

Sikurse te autorët pararendës, edhe te ky autor kemi strukturën e njëjtë të sqarimit. Për Anton Pashkun jepet një pasqyrim për jetën, pastaj kalohet në prozën e tij.

Shkrimtari në këtë lexim letrar është përfaqësuar me tregimin “Lutjet e mbrëmjes”, të cilit tregim do t’ia bëjnë edhe një analizë, por jo shumë të thellë.

Lutjet e mbrëmjes

Në tregimin “Lutjet e mbrëmjes” kemi një shpalim të singertë të botës shumë të ndërlikuar të Asaj, femrës me një pamje të shëmtuar, e cila është aq rëndë e zhytur në kompleksin e saj. Ajo botën e vrojton për jetën dhe bukurinë e saj, nga vetmia që ia vret shpirtin. Meditimet dhe monologun e saj e plotësojnë bukur përshkrimet që i bëhen atmosferës dhe përjetimit të saj. Mjafton të shihet përfundimi i këtij tregimi: “Kurse mjaullima e maces, duke trazuar gjolin e qetësisë në dhomë, e bënte edhe më shurdhuese tërë atë zhurmë të heshtjes së saj.” dhe të shohim sa përputhet ky përshkrim me figuracion aq të pasur me gjendjen shpirtërore të personazhit.

Në leximin letrar IX janë përfshirë gjithsej 21 autorë, jo vetëm shqiptarë por edhe të huaj. Ndërsa sa i përket letërsisë së sotme shqipe, në leximin letrar IX i hasim 3 (14%) autorë.

3.1 Autorët më të spikatur të letërsisë së sotme shqipe në tekstet shkollore

Pasi i analizuam leximin letrar të klasës VI, VII, VIII dhe IX, arritëm në përfundim se autorët më të spikatur të letërsisë së sotme shqipe në këto tekste janë: Ismail Kadare, Ali Podrimja, Sabri Hamiti. Të tjerët të përfshirë janë edhe Anton Pashku, Dritëro Agolli, Bilal Xhaferi, Nasi Lera, Eqrem Basha, Faik Ballanca, por këto janë përfshirë më pak se autorët e lartcekur.

Më poshtë është e paraqitur tabela me autorët më të spikatur të letërsisë së sotme shqipe në tekstet shkollore dhe veprat e tyre:

Tabela 2. Autorët më të spikatur të letërsisë bashkëkohore në tekstet shkollore

Autori	Veprat
Ismail Kadare	<i>Ra si yll po s’u shua; Shënime nga Kapiteneria e Portit; Baladë nizamësh; Kështjella.</i>
Ali Podrimja	<i>Me jetue; Vrima e parë e fyellit tim; Një natë nga netët pa gjumë; Rozafati.</i>
Sabri Hamiti	<i>Detyrat e shtëpisë; Vaji për Prishtinën; Gjumi i diellit</i>

3.1.1 Analiza e teksteve

Pasi shpalosëm tekstet shkollore nga klasa VI-IX, shpërfaqëm autorët e letërsisë së sotme shqipe dhe gjithashtu është bërë analiza e pothuajse të gjitha teksteve të letërsisë së sotme shqipe në përgjithësi nga klasa VI-IX. Por, tek kjo pjesë e punimit ne më shumë do të ndalemi në analizën e veprës “Kështjella” të Ismail Kadaresë dhe “Një natë nga netët pa gjumë” të Ali Podrimës, këto dy analiza do t’i bëjmë në mënyrë më të thelluar sesa tekstet që i kemi analizuar në leximet letrare.

Pse i kemi zgjedhur këto dy tekste? Pasi këto dy shkrimtarë kanë qenë në fokus gjatë teksteve shkollore të klasës VI-IX, ne e kemi parë që këto dy tekste iu përshtaten më shumë moshave të nxënësve dhe janë të një rëndësie të madhe në letërsinë e sotme shqipe.

Një natë nga netët pa gjumë

*Zgjohu Kosovë! Zgjohu nëna ime e dashur,
balli dhe emri im i shkelur,
zgjohu, oj! A po e ndien vajin tim?
A po sheh si ti kam ngulur sytë
mu në zemër, mu në shpirt,
si t’i kam hedhur duart rreth belit
për të përqaftuar unë, ashti yt?
Zgjohu, Kosovë!*

*Nga degët e mia të thyera kush po dahet,
këtë cater kush po e le?
Ç`janë këto gjurmë gjaku që po shtohen
nëpër fytyrën tende,
këto varre e murana që po sillen vërdallë
rreth shtëpisë sime? ...
Zgjohu, Kosovë! Zgjohu, nëna ime e dashur,
balli dhe emri im i shkelur,
Zgjohu, Kosovë! ...
Sonte vetëm mbeta e
në derë të oborrit askush s`po me troket,*

*askush më, thua vdekur jam e harruar
Në këto troje e suka gjaku.
Thua më është shkrimbur hisja
e mbyllur dera e konakut.....
Zgjohu, Kosovë, flakë e hershme e ashtit tim
t`pelcitur.
Bota në ty le të kallet!*

Kjo është njëra nga poezitë e poemës “Hija e tokës” - (Në “Hija e tokës shpërthen poeti, i cili e ka pasur fatin e vështirë të të jatit dhe të gjyshit, ndaj e këndon këtë si bir i tretë, si bir i dhjetë i vuajtjes dhe i mjerimit. Ky është fati i njeriut, që me të lindur është i dënuar të jetojë dhe të luftojë kundët zot-njeriut-pushtues që pushon mbi koka), në të cilën poeti në një patetikë të theksuar i flet atdheut të vet. Ai ngre zërin lart dhe fton atdheun të ruajë krenarinë me gjithë nëpërkëmbjen që i bëhet nga shkelës të huaj. është koha e viteve '50, koha kur në Kosovë u zhvillua aksioni famëkeq i mbledhjes së armëve dhe kur dhuna e shtuar serbe imponoi shpërnguljen masive të shqiptarëve për në Turqi.

Atdheu ai e quan me figura poetike, si balli im, emri im i shkelur, flakë e hershme e gjakut të pëlçitur, kurse veten (njeriun tonë) e sheh si asht të tij, që do të thotë si shtyllë në të cilën ai do të mbahet dhe do t'u bëjë ballë stuhive.

Kështjella

Romani “Kështjella”, i botuar më 1970, është ndër veprat e para të Ismail Kadaresë, me të cilën, sikurse edhe me “Gjeneralin e ushtrisë së vdekur”, i ikën në mënyrë mjeshtërore skematizimit që e impononte metoda e realizimit socialist, duke krijuar kështu një vepër, e cila, edhe si përmbajtje, edhe si strukturë, qysh atëherë qëndron përkrah vlerave letrare të popujve të shteteve me demokraci të zhvilluara. Temën për këtë vepër autori e merr nga e kaluara historike e popullit tonë, nga periudha e Skënderbeut. Si e tillë, ai është roman historik, pasqyron rrethimin e Kështjellës së Krujës nga ushtria osmane dhe rezistencën e kështjellarëve ndaj këtyre pushtuesve.

Romani fillon me vendosjen e trupave osmane përreth kështjellës. Hapësira aty shndërrohet në një kamp me plot tenda, reparte e pajisje të tjera ushtarake. Ushtria, e udhëhequr nga kryekomandanti Turgu Pashai, në fillim bën përpjekje t'i bindë kështjellarët të dorëzoheshin.

Mirëpo, meqë kjo përpjekje dështon, në Këshillin e saj të luftës kjo ushtri bën organizimin dhe planet që qëllimin ta arrijë me luftë. Sulmet e saj vazhdimisht hasin në rezistencën e madhe të kështjellarëve. Përveç të tjerash, ata mbrohen edhe me rrëshirë të valë të cilën ua hedhin ushtarëve turq, nga të cilët me mijëra mbesin të vrarë. Që në sulmin e parë verbohët poeti Sadedin, i cili kishte marrë përsipër ta përjetësojë në vargje ekspeditën turke. Të pasuksesshme dolën planet e shumta, bisedat e pafundta në Këshillin e luftës, konsultimet e njerëzve të ditur si oficerë ushtarak, astrologë, mjekë (Siri Selimi) e të tjerë. Nuk bëjnë punë as operacionet ndëshkimore për plaçkitjen e për djegien e fshatrave, as hapja e gërmojës që nën kështjellë, kështjellarët e rrënojnë atë duke varrosur aty përnjëherësh shumë xhenierë që kishin punuar për hapjen e saj. Nuk ndihmon madje as gjuajtja me topin shkatërrues, sepse edhe ai, në vend se të godas kështjellë, bie në turmën e janiçerëve. Për këtë arsye shpallet se topi është “me xhinde”, kurse ndihmësin e kryemekanikut, Saruxhai, e ekzekutojnë. Për pushtimin e kështjellës nuk bën punë as plani tjetër i Këshillit të luftës që të pengohet shtimi natyror i shqiptarëve, as përpjekja që qëllimi i tyre të arrihet nëpërmjet luftës biologjike-hedhjes së minjve të ngordhur në pusët e ujit. Kështjellarët ishin vazhdimisht zgjuar. Përcillnin çdo hap që ndërmerre armiku dhe ndaj çdo mase të tij organizonin mbrojtjen. Kur turqit zbulojnë ujësjellësin dhe ndalin ujin e pijes, kështjellarët shfrytëzojnë pusët rezervë që të mos vdesin nga etja; kur ushtarët turq hedhin minj të ngordhur në puse, kështjellarët gjejnë puse të tjera rezervë.

Ushtarëve turq ua fuste frikën sidomos lufta që Skënderbeu e zhvillonte natën. Në një rast të tillë atyre u bëhet bira e miut treqind groshë, siç thuhet në popull. Në një vrimë të tillë, madje, ishte mbyllur edhe kronikani Mevla Çelebiu, i cili ishte aty për të shkruar rrjedhën e zhvillimit të ekspeditave të ushtrisë turke. Në sulmin e fundit planifikohet të marrin pjesë drejtpërdrejt edhe të gjithë anëtarët e Këshillit të luftës, si edhe vetë Tursun Pashai, të cilit, kur ngre dorën për të sulmuar, i shkëlqen si rrufeja myhyri në diell. Kështu edhe sulmi i tij, që vjen si masë e fundit e ushtrisë së tij, del i pasukses.

Ndërkohë fillon vjeshta me shira. Në këto kushte pushojnë ekspeditat turke. Në një disponim të tillë të rëndë, pikërisht si dita e vjeshtës me shira e mjegulla, Tursun Pashai, i zhgënjyer dhe i thyer shpirtërisht, pi helmin dhe vdes. Ai vdes me emrin e Skënderbeut në gojë, të cilit ia kishte aq shumë frikën. Në këtë mënyrë merr fund edhe ekspedita e tmerrshme, por edhe jeta dhe karriera e një kryekomandanti të tmerrshëm. Ushtria osmane tërhiqet.

Ky është, në të vërtetë, subjekti i romanit, i cili sidomos për kohën kur u shkrua, por edhe gjithnjë, paraqet një risi sa i përket strukturës, por edhe mënyrës së trajtimit të temës. Në qendër të përmbajtjes së këtij romani është jeta, organizimi, planifikimi dhe realizimi i sulmeve që planifikonte ushtria osmane. Qëndresa dhe lufta e shqiptarëve për mbrojtjen e Kështjellës jepet fare natyrshëm, por me një përshkrim mjeshtëror artistik paraqitet edhe ushtria pushtuese me ushtarët, oficerët e kuadrot e tjera të saj, bota e tyre, psikologjia e personazheve, përshkrimi i zakoneve dhe sjelljeve të tyre.

Në këtë roman autori ka vënë spikamë tri momente apo fakte të rëndësishme historike: e para, kur turqit vijnë në Shqipëri, hasin në një popullsi të krishterë; e dyta, që me ngulimin e tyre aty ata shfaqin haptas qëllimin për islamizmin e popullsisë dhe, e treta, kur tërhiqen nga Shqipëria janë të vetëdijshëm se prapa kanë lënë Evropën. Autori ndërmjet së kaluarës flet për të tashmen dhe të ardhmen e popullit shqiptar: vendi i tij është midis qytetërimit perëndimor.

Romani “Kështjella” është shkruar nga dy këndvrajtime narrative (rrëfimtare): njëri, në vetën e parë, që flet për përjetimet brenda kështjellës, si kronikan i jetës në kështjellë, dhe tjetri, në vetën e tretë, që është kryesori, rrëfimi për jetën dhe veprimet e ushtarëve turq.

3.2 Statistikë

Përmes kësaj statistike do të shohim se sa autorë të letërsisë së sotme shqipe janë përfshirë në tekstet shkollore të klasës VI-IX.

Autorët e letërsisë së sotme shqipe të cilët janë përfshirë në leximin letrar VI-IX janë: *Adem Gajtani, Agim Spahiu, Agim Vinca, Ali Podrimja, Anton Pashku, Arif Demolli, Azem Shkreli, Bardhyl Xhama, Beqir Musliu, Bilal Xhaferi, Din Mehmeti, Dino Buxati, Dritëro Agolli, Eqrem Basha, Faik Ballanca, Gjergj Zheji, Ibrahim Kadriu, Ilirian Zhupa, Ismail Kadare, Jakov Xoxa, Jusuf Buxhovi, Kiço Blushi, Mehmet Kraja, Mihal Hanxhari, Musa Ramadani, Nasi Lera, Naum Prifti, Nazmi Rrahmani, Qamil Batalli, Qerim Ujkani, Ramiz Kelmendi, Rexhep Qosja, Rifat Kukaj, Sabri Hamiti, Skënder Drini, Teki Dervishi, Teodor Laço, Vehbi Kikaj, Yllka Domi dhe Ymer Elshani.*

Leximi letrar VI

Në leximin letrar VI janë përfshirë gjithsej 46 autorë, jo vetëm shqiptarë por edhe të huaj. Ndërsa sa i përket letërsisë së sotme shqipe, në leximin letrar VI i hasim 21 (45%) autorë, e ato janë: *Naum Prifti, Nasi Lera, Teodor Laço, Ismail Kadare, Sabri Hamiti, Dritëro Agolli, Nazmi Rrahmani, Azem Shkreli, Ali Podrimja, Agim Vinca, Ramiz Kelmendi, Qamil Batalli, Ymer Elshani, Ilirian Zhupa, Vehbi Kikaj, Ibrahim Kadriu, Gjergj Zheji dhe Faik Ballanca.*

Leximi letrar VII

Në leximin letrar VII janë përfshirë gjithsej 37 autorë, jo vetëm shqiptarë por edhe të huaj. Ndërsa sa i përket letërsisë së sotme shqipe, në leximin letrar VII i hasim 14 (37%) autorë, e ato janë: *Ismail Kadare, Faik Ballanca, Dritëro Agolli, Teki Dervishi, Anton Pashku, Yllka Domi, Eqrem Basha, Arif Demolli, Ali Podrimja, Bilal Xhaferi, Jusuf Buxhovi, Sabri Hamiti, Dino Buxati dhe Bardhyl Xhama.*

Leximi letrar VIII


Në leximin letrar VIII janë përfshirë gjithsej 44 autorë, jo vetëm shqiptarë por edhe të huaj. Ndërsa sa i përket letërsisë së sotme shqipe, në leximin letrar VIII i hasim 18 (40%) autorë, e ato janë: *Din Mehmeti, Beqir Musliu, Mehmet Kraja, Jakov Xoxa, Mihal Hanxhari, Qerim Ujkani, Agim Spahiu, Rexhep Qosja, Kiço Blushi, Musa Ramadani, Bilal Xhaferi, Ismail Kadare, Rifat Kukaj, Skënder Drini, Nasi Lera, Sabri Hamiti.*

Leximi letrar IX

Në leximin letrar IX janë përfshirë gjithsej 21 autorë, jo vetëm shqiptarë por edhe të huaj. Ndërsa sa i përket letërsisë së sotme shqipe, në leximin letrar IX i hasim 3 (14%) autorë. Të vetmit autorë që janë përfshirë në këtë lexim janë *Ismail Kadare, Anton Pashku dhe Ali Podrimja.*

Në grafikonin në vijim janë shpërfaqur në përqindje autorët e letërsisë së sotme shqipe në tekstet shkollore të klasës VI-IX

Grafikoni 1. Përfshirja e autorëve të letërsisë së sotme shqipe në tekstet shkollore



KAPITULLI V

5. Vëzhgim dhe analizë e pyetësorëve

5.1 Vëzhgimi dhe metodat e punës

Pasi kemi vëzhguar nga dy orë në klasën VI, VII, VIII dhe IX, në orën e letërsisë shqipe në SHFMU “Isa Boletini” dhe SHFMU “Bekim Sylka” në Rahovec, kemi ardhur në përfundim se mësimdhënësit punojnë sipas strukturës së librit dhe metodat nuk janë që ndryshojnë shumë.

Klasa VI

Mësimdhënësi në fillim të orës bën një përsëritje të vogël sa i përket temës së kaluar, pastaj kalon te teksti i ardhshëm, që është vjersha e shkrimtarit Dritëro Agollit “Pyelli qanë për sorkadhen”.

Në fillim nxënësve iu kërkohet që të lexojnë në heshtje, pasi ta lexojnë, të pyesin për ndonjë fjalë të panjohur dhe fillon puna me tekstin. Edhe te puna me tekstin, mësimdhënësi iu jep kohë nxënësve që të mendojnë për përgjigjet më të sakta.

Mësimdhënësi vazhdon me pyetjet: Përse bën fjalë vjersha; Çfarë ndjen për sorkadhen e zënë në çark; Çfarë bëni nëse kafshët kanë nevojë për ndihmën tuaj.

Pasi nxënësit i kanë dhënë përgjigjet e tyre, mësimdhënësi vetëm i plotëson ato dhe kështu ata marrin edhe shënime. Pastaj kalohet në studimin e tekstit, ku mësimdhënësi jep sqarime për metaforën, e cila është përdorur në vjershë.

Detyrë e nxënësve mbetet që ta mësojnë vjershën përmendsh. Ta recitojnë ngadalë, të shqiptojnë mirë fjalët duke shprehur notat e dhembjes e të hidhërimit.

Metodat të cilat i ka përdorur mësimdhënësi janë: monolog, dialog dhe metoda pyetje-përgjigje.

Mësimi ishte shumë efektiv, sepse pasi vëzhgova të njëjtën klasë edhe një orë në vazhdim, nxënësit kanë qenë shumë aktiv dhe e kanë kuptuar shumë mirë vjershën “Pylli qanë për sorkadhen” strofë për strofë.

Klasa VII

Në klasën e shtatë, njësia që do të zhvillohej ishte poezia “Vrima e parë e fyellit tim” e poetit Ali Podrimja.

Në fillim të orës mësimdhënësi i pyet nxënësit se a kanë njohuri rreth autorit Ali Podrimja dhe pastaj vazhdojnë dhe mësojnë më shumë për të. Në këtë lexim është edhe biografia e autorit dhe veprat letrare të tij. Pas kësaj, mësimdhënësi i udhëzon nxënësit që të lexojnë poezinë me zë, një nga një. Më pastaj jep sqarime për metaforën, aliteracionin, distikun që nxënësit ta kenë më të lehtë që ta kuptojnë poezinë e lartcekur.

Pyetjet të cilat bëhen në klasë janë të dhëna në këtë lexim, pra, mësimdhënësi i përmbahet leximit letrar. Pyetjet ishin të tilla: Përse ju pëlqen kjo poezi dhe çka ju përkujton? (Shumica e nxënësve u përgjigjen se ju pëlqen se si përsëriten bashkëtingëlloret dhe zanoret dhe që iu përkujton ndjenjën që janë pranë një lumi); Paramendoni sikur të ndodheni pranë një lumi. Çfarë ndjenje e përjetimit ju përshkon?; Si e shpreh poeti ritmin gurgullues të ujit?; Me çfarë e krahason poeti veten?

Më vonë kalohet tek puna e pavarur, kështu duke nxjerrë disa tipare të ngjashmërisë me gurin si: durimi, urtësia dhe lashtësia.

Metodat që u përdorën në këtë orë janë: metoda monolog dhe dialog dhe puna e pavarur.

Mësimi ishte pothuajse efektiv, këtë e them duke u bazuar se nxënësit kishin pak ngecje në pyetjen “Me çfarë e krahason poeti veten?, Si e shpreh poeti ritmin gurgullues të ujit?”.

Mund të themi se nxënësit kanë nevojë që t’iu sqarohet edhe më shumë për figurat stilistike dhe mësimdhënësi të jap më shumë shembuj për këto figura.

Klasa VIII

Në këtë klasë, ashtu edhe si në klasën e shtatë, metodat e punës janë pothuajse të ngjashme. Por vetëm se në këtë lexim mësohen më shumë figurat stilistike.

Kërkohet nga mësimdhënësi që të bëjë më shumë sqarime dhe nxënësve t’iu jepen detyra që të lexojnë më shumë, sepse kanë ngecje kur bëhet fjalë për analizë. Siç ndodh edhe në poezinë “Këtu” të shkrimtarit Agim Spahiu. Kur nxënësve iu kërkohet të përgjigjen në pyetjen “Cila figurë dominon në këtë poezi?”, ato kanë mëdyshje.

Klasa IX

Në këtë klasë, nxënësit përgatiten që të zhvillojnë shkathtësitë themelore: të dëgjuarit dhe të folurit, leximi dhe shkrimi, në pajtim me nivelin përkatës.

Në orën e mbajtur me klasën e IX, njësia që u zhvillua ishte “Letërsia shqiptare e shekullit XX”.

Fillimisht, u dha një pamje e shkurtër e letërsisë shqiptare e shekullit XX, përkatësisht të letërsisë moderne shqipe, prej tyre ka tekste me të cilat do të punohet për analizë dhe interpretim.

Në orën e parë, mësimdhënësi ishte ai që e udhëhoqi klasën, kështu duke bërë sqarime më të thella për letërsinë moderne. Ndërsa në orën e dytë, ishin nxënësit ata që bënë analiza dhe interpretonin vargjet e autorëve që janë dhënë në leximin letrar.

Detyrë e tyre ishte që të gjejnë elementet e letërsisë gojore në një fragment të dhënë të Gjergj Fishtës.

Mund të themi se kjo lloj pune është shumë efektive dhe sugjerohet që të bëhet në të gjitha klasat pararendëse.


Si përfundim të këtij vëzhgimi mund të themi se metodat e punës në klasën VI dhe IX janë metodat më efektive që nxënësit të kenë një mësim më efektiv. Ndërsa për klasat VII dhe VIII jepen rekomandime që mësimdhënësit të punojnë më shumë dhe librat e klasës së shtatë dhe të nëntë të rishikohen, në mënyrë që nxënësi ta ketë më të qartë atë që e mësojnë.

5.2 Analizë e pyetësorëve

5.2.1 Pyetësor për mësimdhënës


Pyetësori u bë për mësimdhënësit e SHFMU “Isa Boletini” dhe SHFMU “Bekim Sylka” në Rahovec. Në këtë pyetësor kemi 6 respondentë, nga 3 për secilën shkollë. Pyetësori përbëhet prej gjithsej 10 pyetjeve, të gjitha pyetjet janë me opsione. Në grafikonet e mëposhtme shohim përgjigjet e mësimdhënësve në pyetësor.

Grafikoni 2. Cilat tema preken më shumë në leximin letrar të klasave VI-IX?




Në këtë pyetje 3 mësimdhënës janë përgjigjur a) Liria, prej tyre 1 është përgjigjur b) Dashuria dhe 2 të tjerë janë përgjigjur c) Atdheu.

Grafikoni 3. A i përshtaten moshës së fëmijëve këto tema?




Në këtë pyetje 4 mësimdhënës janë përgjigjur a) Po, prej tyre 1 është përgjigjur b) Jo dhe 1 tjerë është përgjigjur c) Mesatarisht.

Grafikoni 4. Cilat janë metodat që i përdorni më shpesh gjatë punës?




Në këtë pyetje 2 mësimdhënës janë përgjigjur a) Metoda verbale, prej tyre 1 është përgjigjur b) Metoda: shkrim i lirë dhe 3 të tjerë është përgjigjur c) Tjetër, kështu duke cekur metodat: shprehja e mendimit të lirë, shkrim ese, të punuarit në grup etj.

Grafikoni 5. A motivohen nxënësit të kyçen në mësim përmes këtyre metodave?




Në këtë pyetje 5 mësimdhënës janë përgjigjur a) Po, dhe 1 është përgjigjur c) Mesatarisht.

Grafikoni 6. Sa janë produktive dhe a sjellin risi ato te nxënësit në të nxënit e tyre për letërsinë?



Në këtë pyetje 5 mësimdhënës janë përgjigjur a) Po, dhe 1 tjerë është përgjigjur c) Mesatarisht.


Grafikoni 7. Cila letërsi është e përfshirë më shumë në leximin letrar të klasave VI-IX?



Në këtë pyetje 1 mësuesdhënë është përgjigjur a) Letërsia e vjetër shqipe, prej tyre 1 është përgjigjur b) Letërsia moderne shqipe dhe 4 të tjerë janë përgjigjur c) Letërsia bashkëkohore shqipe.


Grafikoni 8. A duhet të përfshihen më shumë autorët e letërsisë së sotme shqipe në tekstet shkollore?

7. A duhet të përfshihen më shumë autorët e letërsisë së sotme shqipe në tekstet shkollore?




Në këtë pyetje 6 mësimdhënës janë përgjigjur a) Po

Grafikoni 9. A duhet të bëhet një rishikim i leximeve letrare, që nxënësit të marrin njohuri më shumë për letërsinë?




Në këtë pyetje 5 mësimdhënës janë përgjigjur a) Po, prej tyre 1 është përgjigjur b) Jo.

Grafikoni 10. A kanë pasur njohuri paraprake nxënësit për veprat e shkrimtarëve të letërsisë së sotme shqipe?



Në këtë pyetje 2 mësime janë përgjigjur a) Po, prej tyre 2 janë përgjigjur b) Jo dhe 2 të tjerë janë përgjigjur c) Mesatarisht.

Grafikoni 11. Cilët autorë janë përfshirë më shumë në leximin letrat VI-IX?




Në këtë pyetje 4 mësimdhënës janë përgjigjur a) Ismail Kadare, prej tyre 1 është përgjigjur b) Ali Podrimja dhe 1 tjerë është përgjigjur c) Sabri Hamiti.

5.2.2 Pyetësor për nxënës

Pyetësori u bë për nxënësit e SHFMU “Isa Boletini” dhe SHFMU “Bekim Sylka” në Rahovec. Në këtë pyetësor kemi 20 respondentë, nga 10 për secilën shkollë, nxënësit të cilët e kanë plotësuar këtë pyetësor, kanë qenë nxënës së klasës së nëntë, kjo për arsye që të shohim se sa kanë marrë njohuri gjatë këtyre viteve shkollore. Pyetësori përbëhet prej gjithsej 10 pyetjeve, të gjitha këto janë me opsione. Në grafikonet e mëposhtme shohim përgjigjet e nxënësve në pyetësor.

Grafikoni 12. Në cilat vite filloi zhvillimi i letërsisë bashkëkohore?


1. Në cilat vite filloi zhvillimi i letërsisë bashkëkohore



Në këtë pyetje 2 nxënës janë përgjigjur a) '30, prej tyre 3 janë përgjigjur b) '40 dhe 15 të tjerë janë përgjigjur c) '50.

Grafikoni 13. Në sa periudha ndahet letërsia shqipe?


2. Në sa periudha ndahet letërsia shqipe?



Në këtë pyetje 16 nxënës janë përgjigjur a) 3, prej tyre 3 janë përgjigjur b) 4 dhe 1 tjerë është përgjigjur c) 5.

Grafikoni 14. Cili autor i përket letërsisë së vjetër shqipe?


3. Cili autor i përket letërsisë së vjetër shqipe?



Në këtë pyetje 6 nxënës janë përgjigjur a) Fan Noli, prej tyre 2 janë përgjigjur b) Ismail Kadare dhe 12 të tjerë janë përgjigjur c) Gjon Buzuku.

Grafikoni 15. Cili autorë i përket letërsisë moderne shqipe?


4. Cili autorë i përket letërsisë moderne shqipe?



Në këtë pyetje 2 nxënës janë përgjigjur a) Ali Podrimja , prej tyre 17 janë përgjigjur b) Faik Konica dhe 1 tjerë është përgjigjur c) Pjetër Bogdani

Grafikoni 16. Cili autorë i përket letërsisë bashkëkohore shqipe?


5. Cili autorë i përket letërsisë bashkëkohore shqipe?



Në këtë pyetje 6 nxënës janë përgjigjur a) Eqrem Çabej, prej tyre 1 është përgjigjur b) Faik Konica dhe 13 të tjerë janë përgjigjur c) Anton Pashku.

Grafikoni 17. A janë këto shkrimtarë bashkëkohorë: Dritëro Agolli, Jakov Xoxa, Rexhep Qosja dhe Ag Apolloni?


b. A janë këto shkrimtarë bashkëkohorë: Dritëro Agolli, Jakov Xoxa, Rexhep Qosja dhe Ag Apolloni?



Në këtë pyetje 15 nxënës janë përgjigjur a) Po, prej tyre 3 janë përgjigjur b) Jo dhe 2 të tjerë janë përgjigjur c) Nuk e di.

Grafikoni 18. Nga cili autor është shkruar vepra “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”?


7. Nga cili autor është shkruar vepra “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”?



Në këtë pyetje 1 nxënës është përgjigjur a) Rexhep Qosja dhe 19 të tjerë janë përgjigjur c) Ismail Kadare.

Grafikoni 19. Kush e ka shkruar poezinë “Me jetue”?


8. Kush e ka shkruar poezinë “Me jetue”?



Në këtë pyetje 8 nxënës janë përgjigjur a) Ali Podrimja, prej tyre 9 janë përgjigjur b) Jakov Xoxa dhe 3 të tjerë janë përgjigjur c) Ismail Kadare.

Grafikoni 20. A keni lexuar ndonjë vepër të autorit Ag Apolloni?


9. A keni lexuar ndonjë vepër të autorit Ag Apolloni?



Në këtë pyetje 19 nxënës janë përgjigjur b) Jo dhe 1 tjerë është përgjigjur c) Tjetër, dhe ka theksuar këtë “Kam lexuar një poezi të tij në internet”.

Grafikoni 21. Cila ishte tema kryesore e veprës “Kështjella” e shkrimtarit Ismail Kadare?

10. Cila ishte tema kryesore e veprës “Kështjella” e shkrimtarit Ismail Kadare?



Në këtë pyetje 5 nxënës janë përgjigjur a) Dhuna mbi individin, prej tyre 4 janë përgjigjur b) Liria dhe 16 të tjerë janë përgjigjur c) E kaluara historike e popullit shqiptar, nga periudha Skënderbeut.

Përfundim

Ky punim masteri trajtoi përfshirjen e autorëve të letërsisë së sotme shqipe në tekstet shkollore të klasave VI-IX, përkatësisht në tekstin “Leximi letrar”. Pra, si bazë e hulumtimit ka qenë letërsia e sotme shqipe. Mund të themi se punimi del të jetë me shumë rëndësi, ngase shpalos se sa u ofrohet nxënësve njohuri nga letërsia në tekste shkollore, kryesisht nga Letërsia e sotme shqipe.

Letërsia e sotme shqipe apo bashkëkohore filloi në vitet '50. Ajo karakterizohet me të veçantat e saj, njëjtë sikurse letërsitë pararendëse. Kjo periudhë letrare kishte një numër të konsiderueshëm shkrimtarësh në “Leximin letrar” të klasave VI-IX, e ata janë: *Adem Gajtani, Agim Spahiu, Agim Vinca, Ali Podrimja, Anton Pashku, Arif Demolli, Azem Shkreli, Bardhyl Xhama, Beqir Musliu, Bilal Xhaferi, Din Mehmeti, Dino Buxati, Dritëro Agolli, Eqrem Basha, Faik Ballanca, Gjergj Zheji, Ibrahim Kadriu, Ilirian Zhupa, Ismail Kadare, Jakov Xoxa, Jusuf Buxhovi, Kiço Blushi, Mehmet Kraja, Mihal Hanxhari, Musa Ramadani, Nasi Lera, Naum Prifti, Nazmi Rrahmani, Qamil Batalli, Qerim Ujkani, Ramiz Kelmendi, Rexhep Qosja, Rifat Kukaj, Sabri Hamiti, Skënder Drini, Teki Dervishi, Teodor Laço, Vehbi Kikaj, Yllka Domi dhe Ymer Elshani*. Sipas statistikës së bërë për përfshirjen e autorëve të letërsisë së sotme në tekstet shkollore del që klasa VI përfshinë 45% të autorëve në leximin letrar, klasa VII 37%, klasa VIII 40% dhe klasa IX 14%.

Përfundimisht mund të themi se autorët e Letërsisë së sotme shqipe, të përfshira në tekstet shkollore, ua krijojnë nxënësve idenë për letërsi dhe i sjellin atyre paksa të mangëta sa i përket autorëve të kësaj periudhe, kështu që një rishikim i tyre do të ishte më se i domosdoshëm.

Sa i përket pyetësorëve që janë realizuar në SHFMU “Isa Boletini” dhe SHFMU “Bekim Sylka” në Rahovec, arrijmë në përfundim që njohuria e nxënësve rreth letërsisë bashkëkohore nuk është edhe fort e kënaqshme. Prandaj, kërkohet që nga mësimdhënësit të punohet më shumë sa i përket kësaj periudhe të letërsisë dhe të përdoren metoda më efikase në mësim.

Bibliografia

1. “*Historia e letërsisë shqipe*”, materialet e Konferencës shkencore 30-31 tetor 2009, në Prishtinë. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2010.
2. “*Poezia e Bejtexhinjve*”, UEGEN, Tiranë, 2010.
3. Aliu Ali, “*Teoria e letërsisë*”, Prishtinë, 1986.
4. Hamiti Sabri, “*Letërsia bashkëkohore*”, Vepra letrare 9, Prishtinë, 2002.
5. Hamiti Sabri, “*Letërsia e vjetër shqiptare*”, Prishtinë, 2007.
6. Hamiti Sabri, “*Letërsia moderne shqipe*”, Prishtinë, 2005.
7. Hamiti Sabri, “*Studime letrare*”, Prishtinë, 2003.
8. Kuçuku, B., “*Bota poetike e Dritëro Agolli*”, në revistën Studime filologjike, 1991/1.
9. Luboteni Gani, “*Teoria e letërsisë*”, Beograd, 1964.
10. Milivoj Solar, “*Teoria e letërsisë*”. Përktheu Ali Aliu, Prishtinë, 1978.
11. Ndocaj Filip, “*Petro Marko: poeti, publicisti dhe romancieri ynë...*”, Nëntori, 1973.
12. Qosja Rexhep, “*Letërsia e Rilindjes dhe romantizmi evropian*”, Prishtinë, 1975.
13. Qosja, R., “*Prej letërsisë romantike deri te letërsia moderne*”, Prishtinë, 2006.
14. Qosja, Rexhep, “*Historia e letërsisë shqipe – Romantizmi I, II, III*”, Prishtinë, 1984-85.
15. Qosja, Rexhep, “*Prej Tipologjisë deri te periodizimi*”, Prishtinë, 1979.
16. Rene, W., Austin, W., “*Teoria e letërsisë*”, Tiranë, 2007.
17. Shema Isak, “*Kultura letrare bashkëkohore*”, Prishtinë, 2015.
18. Vinca Agim, “*Alternativa letrare shqiptare*”, Shkup, 2005.
19. Vinca, A., “*Orët e poezisë*”, Prishtinë, 2010.
20. Zejnullah Rrahmani “*Teoria e letërsisë*”, Prishtinë, 1999.

Linqe

21. <https://2lonline.com/skenderbeu-i-mitizuar-ne-poemen-e-shkrimtarit-beqir-musliu/> (qasja e fundit më 15.02.2019)
22. <https://2lonline.com/skenderbeu-ne-poezine-e-beqir-musliut/> (qasja e fundit më 15.02.2019)
23. https://sq.wikipedia.org/wiki/Drit%C3%ABro_Agolli#cite_note-2 (qasja e fundit më 10.10.2018)

24. https://sq.wikipedia.org/wiki/Drit%C3%ABro_Agolli#cite_note-GjSh-4 (qasja e fundit më 23.10.2018)
25. https://sq.wikipedia.org/wiki/Jusuf_G%C3%ABrvalla (qasja e fundit më 24.01.2019).
26. https://sq.wikipedia.org/wiki/Teki_Dervishi (qasja e fundit më 09.12.2019)
27. https://sq.wikipedia.org/wiki/Zef_Zorba (qasja e fundit më 02.01.2019).
28. https://sq.wikipedia.org/wiki/Zejnullah_Rrahmani (qasja e fundit më 17.11.2018).

Korpusi hulumtues

29. Demolli Arif, Syla Xhevat, “*Leximi letrar 9*”, Prishtinë, 2016, Libri shkollor.
30. Kumanova Mazllom , Hyseni Munish, (2015), *Leximi letrar 8*, Prishtinë , Libri shkollor.
31. Kumanova Mazllum, Hyseni Munish, (2015), *Leximi letrar 7*, Prishtinë , Libri shkollor.
32. Petro Rita, Syla Xhevat, (2014), *Leximi letrar 6*, Prishtinë, Libri shkollor.

Shtojca

Nga ju kërkojmë që të lexoni me vëmendje pyetjet të cilat i kam formuluar dhe të ofroni përgjigjet të cilat janë sipas mendimit tuaj më të favorshme. Përgjigjet tuaj do të na ndihmojnë dhe të japin një kontribut të veçantë për realizimin sa më të mirë të këtij punimi të masterit.

Pyetësor për mësimdhënës

1. Cilat tema preken më shumë në leximin letrar të klasave VI-IX?

- a) Liria
- b) Dashuria
- c) Atdheu

2. A i përshtaten moshës së fëmijëve këto tema?

- a) Po
- b) Jo
- c) Mesatarisht

3. Cilat janë metodat që i përdorni më shpesh gjatë punës?

- a) Metoda verbale
- b) Metoda: shkrim i lirë
- c) Tjetër _____

4. A motivohen nxënësit të kyçen në mësim përmes këtyre metodave?

- a) Po
- b) Jo
- c) Mesatarisht

5. Sa janë produktive dhe a sjellin risi ato te nxënësit në të nxënit e tyre për letërsinë?

- a) Po

- b) Jo
- c) Mesatarisht

6. Cila letërsi është e përfshirë më shumë në leximin letrar të klasave VI-IX?

- a) Letërsia e vjetër shqipe
- b) Letërsia moderne shqipe
- c) Letërsia bashkëkohore shqipe

7. A duhet të përfshihen më shumë autorët e letërsisë së sotme shqipe në tekstet shkollore?

- a) Po
- b) Jo
- c) Tjetër _____

8. A duhet të bëhet një rishikim i leximeve letrare, që nxënësit të marrin njohuri më shumë për letërsinë?

- a) Po
- b) Jo
- c) Tjetër _____

9. A kanë pasur njohuri paraprake nxënësit për veprat e shkrimtarëve të letërsisë së sotme shqipe?

- a) Po
- b) Jo
- c) Mesatarisht

10. Cilët autorë janë përfshirë më shumë në leximin letrar VI-IX?

- a) Ismail Kadare
- b) Ali Podrimja
- c) Sabri Hamiti

Pyetësor për nxënës

1. Në cilat vite filloi zhvillimi i letërsisë bashkëkohore

- a) '30
- b) '40
- c) '50

2. Në sa periudha ndahet letërsia shqipe?

- a) 3
- b) 4
- c) 5

3. Cili autor i përket letërsisë së vjetër shqipe?

- a) Fan Noli
- b) Ismail Kadare
- c) Gjon Buzuku

4. Cili autorë i përket letërsisë moderne shqipe?

- a) Ali Podrimja
- b) Faik Konica
- c) Pjetër Bogdani

5. Cili autorë i përket letërsisë bashkëkohore shqipe?

- a) Eqrem Çabej
- b) Faik Konica
- c) Anton Pashku

6. A janë këto shkrimtarë bashkëkohorë: Dritëro Agolli, Jakov Xoxa, Rexhep Qosja dhe Ag Apolloni?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk e di

7. Nga cili autor është shkruar vepra “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”?

- a) Rexhep Qosja
- b) Eqrem Basha
- c) Ismail Kadare

8. Kush e ka shkruar poezinë “Me jetue”?

- a) Ali Podrimja
- b) Jakov Xoxa
- c) Ismail Kadare

9. A keni lexuar ndonjë vepër të autorit Ag Apolloni?

- a) Po
- b) Jo
- c) Tjetër _____

10. Cila ishte tema kryesore e veprës “Kështjella” e shkrimtarit Ismail Kadare?

- a) Dhuna mbi individin
- b) Liria
- c) E kaluara historike e popullit shqiptar, nga periudha Skënderbeut